



**TË DREJTAT E PËRGJITHSHME
PËR "EHLU DHIMME",
JOMYSLIMANËT**



XHENETI DHE ZJARRI



**TOKA U LËKUND,
TË MOS LËKUNDEN ZEMRAT**

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 17 - Nr. 12 (202), Dhjetor, 2019

www.myftinia-shkoder.org



MYFTINIA SHKODER1990

**TË DËSHMOJMË BOTËRISHT
LIDHJEN TONË ME EMRIN
E HZ. MUHAMMEDIT (A.S.)!**



"S fida e jonë është angazhimi për të dëshmuar botërisht dhe pa asnjë lloj pengese përkatësinë tonë të shenjtë fetare! Përkatësinë tonë të shenjtë, që lidhet me emrin e Hz. Muhammedit (a.s.)!

Nëse dikush ka të drejtë të mburret me historinë e tij të bardhë dhe të ndershme, jemi ne muslimanët! Se, historia e jonë është histori lavdie!"

U PËRURUA XHAMIA E RE E FSHATIT SHIRQ



**MYFTIU MORI PJESË NË MEVLUDIN
E XHAMISË "BUHARA" NË SULGEN TË ZVICRËS**





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

TË DËSHMOJMË BOTËRISHT LIDHJEN TONË ME EMRIN E HZ. MUHAMMEDIT (A.S.)!

Sfida e jonë, të dashurit e mi, është angazhimi për të dëshmuar botërisht dhe pa asnjë lloj pengese përkatësinë tonë të shenjtë fetare! Përkatësinë tonë të shenjtë, që lidhet me emrin e Hz. Muhammedit (a.s.)!

Na mjafton ne muslimanëve shqiptarë të mburremi e të ndjehemi krenarë me Sulltan Mehmet Fatihun dhe sulltanët e hilafetit tonë osman, se jemi pjesë e tij, jemi ndërtues të botës, jemi përhapës të civilizimeve, jemi përhapës të dritës së Hazreti Pejgamberit tonë (a.s.)!

Përse të tundohet atëherë muslimani i sotëm dhe t'i kthejë shpinën fesë së tij? Prej kujt? Nga frika e kujt, a nga tundimi i kujt?

Shikoni, atje ku ju tërheqin për të shkuar e për t'u kthyer, se çfarë modelesh dekadente ka, kur bëhet fjalë për familjen, për nderin, për besën, për pastërtinë, për besimin! Shikoni, shikoni!

Prandaj, ne si muslimanë, e kemi për detyrë ta ruajmë fort fenë e All-llahut të Madhëruar dhe jo të ulim krye e të fshihemi!

Ne nuk fusim hundët në punët e të tjerëve, por ne kemi modelin më të mirë të mundshëm, modelin më të pastër të mundshëm, modelin më krenar të mundshëm dhe, i kthejmë shpinën?!

A mos vallë kemi gjetur diçka më të mirë se Kur'ani Famëllartë? Jo pasha All-llahun, nuk ka! A mos vallë kemi gjetur diçka më të mirë se Drita e Hazreti Muhammedit (a.s.)? Jo pasha All-llahun, nuk ka! A mos vallë kemi gjetur diçka më të mirë se tradita e baballarëve, hoxhallarëve tanë e të shkuarve tanë, që ishin dhe ngelen nderi i jonë dhe krenaria e jonë? Jo pasha All-llahun, nuk ka!

Atëherë, çfarë është, të dashurit e

mi? Kjo është një pyetje që duhet t'ia drejtojë gjithsecili vetes së tij, duke parë në familjen e tij, fëmijët e tij e të afërmit e tij, sidomos sot, që po prishen zemrat e po shpërbëhet dashamirësia dhe afrimiteti në mesin e njerëzve!

Prandaj ejani të kthehemi nga feja

NA MJAFTON NE MUSLIMANËVE SHQIPTARË TË MBURREMI E TË NDJEHEMI KRENARË ME SULLTAN MEHMET FATIHUN DHE SULLTANËT E HILAFETIT TONË OSMAN, SE JEMI PJESË E TIJ, JEMI NDËRTUES TË BOTËS, JEMI PËRHAPËS TË CIVILIZIMEVE, JEMI PËRHAPËS TË DRITËS SË HAZRETI PEJGAMBERIT TONË (A.S.)!

e All-llahut e të jetojmë me dinjitet si muslimanë të ndershëm e të përkushtuar ndaj fesë së tyre, që tolerojnë ku duhet e, që mbrojnë me dinjitet e pa asnjë lëshim shenjtëritë dhe modelet e shëndosha shekullore!

Ejani të dëshmojmë botërisht lidhjen tonë me emrin e Hz. Muhammedit (a.s.)!

(Nga hytbeja e xhumasë, më 27 dhjetor 2019, në xhaminë e Dërgutit)

Sfida e jonë, të dashurit e mi, është angazhimi për të dëshmuar botërisht dhe pa asnjë lloj pengese përkatësinë tonë të shenjtë fetare! Përkatësinë tonë të shenjtë, që lidhet me emrin e Hz. Muhammedit (a.s.)!

Ju e shikoni sot, se si në vende të ndryshme të botës, nga lindja në perëndim, muslimanët po vriten, po u shkelen të drejtat në mënyrë të barbare, nga ata që pretendojnë civilizimin dhe zhvillimin e botës!

Ju po e shihni edhe në vendin tonë se si trajtohen muslimanët, se si ka një tendencë për ta zhveshur Islamin nga zemra dhe shpirti i shqiptarëve! Se si ka një tendencë të pandershme, edhe nga njerëz me rrobën fetare, për të luajtur pandershmerisht me simbolet fetare!

Po e shikoni ditë pas dite, se si ka një përpjekje për të edukuar brezin e ri me një frymë që nuk është fryma islame, edhe pse ata janë bijtë e muslimanëve!

Prandaj, nuk duhet t'i dridhet goja, zemra e shpirti muslimanit shqiptar për ta dëshmuar identitetin e tij!

Nëse dikush ka të drejtë të mburret me historinë e tij të bardhë dhe të ndershme, jemi ne muslimanët! Se, historia e jonë është histori lavdie!



MË I MIRI I YMETIT ISLAM...

Hadithi: "Më i miri i ymetit tim është Ebu Bekri dhe Omeri", në vetvete është hadithi i mirënjohjes në jetë. Ai është hadithi i vlerësimit dhe nderimit të më të spikaturve për vlerat dhe kontributet e tyre!

Është një nxitje që na bën i Dërguari i All-llahut (a.s.) që të vlerësojmë kolegët tanë, shokët e mirë, familjarët, deri tek fëmijët, tek të cilët jemi të ftuar të gjejmë vlerat e fshehura, talentin dhe prirjet në jetë!

AI ISHTE BURRI I PARË QË PRANOI ISLAMIN. SIKURSE ISHTE I VETMI, QË NUK KISHTE ASNJË DILEMË NË ATË, DREJT SË CILËS U FTUA NGA I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S.)!

Ky është një hadith i mrekullueshëm që na mëson se, në jetën e tij, njeriu duhet të ketë momente reflektimi dhe llogaritjeje, në të cilët vlerëson miqtë e mirë, shokët e afërt, familjarët e shtrenjtë, pa të cilët, jeta e tij do ishte shumë e varfër.

Prandaj, teksa lexojmë këtë hadith të shkurtër në përbërje, por shumë të gjatë në hapësirat e mirësive dhe vlerave që përcjell, kuptojmë madhësinë e

fesë dhe edukatorit të saj, që përherë na merr për dore drejt korrektësisë dhe mirënjohjes ndaj njerëzve të rëndësishëm të jetës sonë!

Pastaj, duke u kthyer tek hadithi në fjalë, nuk ka dyshim se, më i miri dhe më i spikatur për besimin, përkushtimin, dashurinë dhe sakrificën e tij, është Hz. Ebu Bekri (r.a.).

Ai ishte burri i parë që pranoi Islamin. Sikurse ishte i vetmi, që nuk kishte asnjë dilemë në atë, drejt së cilës u ftua nga i Dërguari i All-llahut (a.s.)!

Quhet Abdull-llah ibn Osman (Ebu Kuhafe) ibn Amir. Takohet me Resulull-llahun (a.s.) tek gjyshi i tij i shtatë, Murreh bin Ka'b. Para Islamit quhej Abdul-Kabeh, ndërsa Resulull-llahu (a.s.) e quajti Abdull-llah dhe kështu u njoh: Abdull-llah ibn Ebi Kuhafe.

Dhe, siç na mësojnë më të diturit tanë: [Akideja (besimi) e jonë (Ehli-Sunneh Vel-Xhemaah), është se, më i miri i sahabëve është Hz. Ebu Bekri (r.a.), pastaj Hz. Omeri (r.a.). Dhe ky është konsensusi (ixhmaja) i Ehli-Sunnetit. Imam Neveviu thotë: 'Më i miri i tyre (i sahabëve) në mënyrë absolute, është Ebu Bekri, pastaj Omeri, All-llahu qoftë i kënaqur me të dy. Ky është konsensusi i Ehli-Sunnetit', sikurse lexojmë edhe në veprat e dijetarit të shquar bashkëkohor, Shejkh Ibrahim En-Ni'meh.

(Nga dersi i sabahut, më 2.12.2019, nga Imam Muhamed B. Sytari, në xhaminë e Parrucës)

NË GJURMËT E DRITSHME TË HZ. OMERIT (R.A.)...

Është e mrekullueshme dëshmia e Resulull-llahut (a.s.) për Hz. Omerin (r.a.): "Eh, o i biri i Hattabit, pasha Atë që e ka shpirtin tim në dorën e Tij, çdoherë që shejtani të sheh në një shteg, devijon rrugë në një shteg, larg shtegut tënd!"

Jam ndalur shpesh tek ky hadith. Është një ftesë për të menduar e reflektuar se çfarë është kjo gjendje dhe ky besim, që e bën individin musliman të mbërrijë në këtë gradë të lartë, sa që edhe shejtani të distancohet prej tij?

Nga ana tjetër, imagjino një shoqëri, individët e së cilës prodhojnë vlere e rrezatojnë besim e mirësi, aq sa edhe shejtani të largohet prej tyre! Është

shoqëri e vlerave dhe bekimeve hyjnore; shoqëri, individët e së cilës janë përherë garanci për ruajtjen e paqes, sigurisë, mirëqenies dhe përparimit, drejt të cilëve fton Kur'ani e, për të cilët punoi e sakrifkoi Resulull-llahu (a.s.)!

Me fjalë të tjera, kur besimtari e lidh zemrën e tij me All-llahun e Madhëruar është i vendosur në fenë e tij, i qëndrueshëm në besimin e tij; me dinjitet e krenari e dëshmon fenë e tij, edhe shejtani devijon rrugën, në të cilën ai lëviz!

Një besimtar i tillë, prej të cilit largohet edhe shejtani, është si një antivirus në shoqërinë e tij, kundër padrejtësisë, korrupsionit e ligësive,

REFLEKTIM I PËRSËRITUR, NË KUSHTET E LAICIZMIT SELEKTIV!

Myftinia Shkodër, më 26 dhjetor 2019

Arroganca, mendjelehtësia dhe euforizmi i mbështetur në politika të dështuara të institucioneve promotore të kulturave të rrezikshme të intolerancës, përçarjes dhe mesjetarizmit inkvizitor, prodhojnë përherë stereotipe meskine, që janë të gatshëm të hedhin në erë çdo mesazh paqeje, bashkëjetese e harmonie ndërfaqetare në këtë vend!

Përballë kësaj fryme, qytetaria, toleranca dhe fryma e bashkëpunimit konsiderohen dobësi, por veç dobësi nuk mund të jetë!



(Në foto: XHAMIA E SULLTAN MEHMET FATIHUT, në kalanë e Shkodrës, sot në administrim ilegjitim të Ministrisë së Kulturës)

kundër imoralitetit e shturjes!

Kur Resulull-llahu (a.s.) e përgëzon Hz. Omerin (r.a.) me këtë dëshmi të madhe, njëkohësisht po i thotë çdo muslimani që të jetë njeriu model në shoqërinë e tij, deri në atë gradë sa edhe shejtani të largohet prej tij. Mirëpo, njeriu nuk e arrin këtë gradë besimi, pa e shikuar mirë marrëdhënien që ka me All-llahun e Madhëruar! Një person që do të ecë në këtë rrugë është një individ që nuk e lë pas dore dhikrin e Zotit të vet, që e mbikëqyr Atë në çdo moment të jetës, sidomos kur veçohet prej njerëzve!

(Nga dersi i sabahut, më 16.12.2019, nga Imam Muhamed B. Sytari, në xhaminë e Parrucës)



Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Tërmetet dhe krejt fenomenet natyrore janë në dorën e Allahut dhe jo ndryshe. Tërmeti është vendimi i Allahut që ndodh sipas ligjeve të Tij. Ato janë argumente që Allahu (xh.sh) ia dërgon njerëzimit për të kuptuar madhësinë e Tij, fuqinë e Tij, për t'u frikësuar prej Tij, për të kryer obligimet ndaj Tij dhe për tu larguar nga veprat e këqija që më pas sjellin hidhërimin e Allahut.

Njeriu në momentin e ndodhisë së këtyre fenomeneve duhet të përkujtojë dobësinë, paaftësinë, përlulësinë e tij përpara Allahut dhe nevojën e tij për Të. Ai i kthehet Allahut të Lartësuar, me lutje, përlulësi dhe me shpresë se Allahu do ta largojë këtë shqetësim të madh nga populli.

Ne nuk duhet të shprehemi që kjo ngjarje dhe të tjera si kjo ndodhin si pasojë e lënies së rrugës së Zotit, si pasojë e gjynaheve etj. Besoj që nuk është koha për këto lloj debatesh por është koha për lutje, këshilla, porosi që t'i kthehemi Zotit të shikojmë punët tona. Të bëjmë apel për unitet e bashkim e jo të kemi qasje qortuese që gjoja ne jemi të pastër si melekët e Zotit e të tjerët janë gjynahqarë e shkaktarë të kësaj situatë. Nëse shkaktarë të tërmetit janë gjynahet atëherë të gjithë jemi gjynahqarë dhe duhet të pendohejmë. Allahu (xh.sh) thotë: "Njerëzve u dërgojmë shenja që të bëhen të vetëdijshëm dhe të frikësohen për punët që bëjnë".¹

Disa udhëzime fetare për tejkalimin e këtyre situatave

1. Në raste fatkeqësie duhet të themi ashtu siç na ka mësuar Allahu (xh.sh). "Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi".² Pejgamberi (a.s) na ka mësuar se çfarë të themi në sprovë të caktuara. Kur njeriu e godet ndonjë

1. Kur'ani, El-Isra: 59.
2. Kur'ani, El-Bekare: 156.

TOKA U LËKUND, TË MOS LËKUNDEN ZEMRAT

sprovë duhet të thotë: "Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi, O Zot më shpërble në këtë fatkeqësi që më ka kapluar dhe ma zëvendëso me diçka më të mirë se kjo".³

2. Gjërat që ndodhin nuk duhet të na bëjnë që të kemi mendim të keq për Allahun (xh.sh). Nëse është lëkundur toka dhe shtëpitë tona nuk duhet që të na lëkundin zemrat tona në raport me Allahun e Madhëruar. Një njeri e pyeti Ibn Abasin (Allahu qoftë i kënaqur me të), dhe i tha: Kush i llogarit njerëzit Ditën e Kiametit? Allahu – u përgjigj. Shpëtuam, pasha Allahu – tha njeriu me gjithë gëzim. (Sa i bukur që është mendimi i mirë për Allahun).

3. Bindja se çdo gjë ndodhë me lejen dhe caktimin e Allahut.

Allahu (xh.sh) thotë: "...Asnjë gjë nuk bie, pa dijeninë e Tij..."⁴ "Çdo fatkeqësi që i bie njeriut, ndodh me vullnetin e Allahut".⁵

Pejgamberi (a.s) lutej në këtë mënyrë: "O Zot im, kërkoj prej Teje pajtim pas caktimit".⁶ (Atë që ma cakton Ti, bëj që të pajtohem me të). Pejgamberi (a.s) e ka këshilluar Ibn Abasin (r.a) duke i thënë: "...Dije se, sikur të gjithë njerëzit të mblidhen për të të bërë mirë, nuk do të bëjnë më tepër sesa ka shkruar Allahu. Edhe sikur të gjithë njerëzit të mblidhen për të të bërë keq, nuk do të bëjnë më shumë sesa ka shkruar Allahu."⁷

4. Pejgamberi (a.s) na ka mësuar që në situatë të tilla të falim namaz, të përmirësojmë raportet tona me Allahun (xh.sh), të shtojmë lutjet dhe kërkimin e faljes, siç na porositë në hadithin e tij: "Vërtetë Dielli dhe Hëna janë prej shenjave të Allahut. Allahu me to frikëson robërit e Tij, prandaj nëse shihni (eklipsin) të ndodhë, atëherë shpejtoni përkujtimin e Allahut, faljen e namazit, duanë dhe kërkimin e faljes."⁸ Namazi, dua ja dhe gjithashtu leximi i Kur'anit janë prej gjërave me të dobishme që ndihmojnë që njeriu të jetë i qëndrueshëm gjatë sprovave. Kur i Dërguari i Allahut, preokupohej me ndonjë çështje, kërkonte prehje me

3. Transmetuar nga Muslimi.

4. Kur'ani, El-En'am: 59.

5. Kur'ani, Et-Tegabun: 11.

6. Transmetuar nga Abdu Rrezak në Musanef, Taberani në "El-Evsat", Hakimi. Shejh Albani në "Dhilal el-Xheneh" e ka konsideruar të saktë.

7. Transmetuar nga Tirmidhiu.

8. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

namaz.⁹

5. Dua ja, lutja. Një person nga gjeneratat e para u pyet: A nje dikë që lutjen e ka të pranuar tek Allahu? Tha: Jo, por e njoh Atë që i pranon lutjet. (Allahun xh.sh). Allahu i madhëruar na ka urdhëruar që t'i bëjmë dua Atij dhe Ai na ka premtuar se do të na përgjigjet. Ai thotë: "Mu lutni Mua se do t'ju përgjigjem!"¹⁰ Pejgamberi (a.s) na ka mësuar që kur të jemi në gjendje sprovë të lutemi: "O Allah! Në mëshirën Tënde shpresoj! Mos më lër të mbështetem në veten time as sa një pulitje sysh dhe m'i rregullo mua të gjitha çështjet e mia! Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje!"¹¹

6. Sadakaja është shkak për shmangien e sprovave dhe fatkeqësive. Është transmetuar nga Omer ibn Abdulaziz (r.h), se ai u shkruante udhëheqësve të tij që kur të ndodhin tërmetet, të jepnin lëmshë.

7. Nëse njeri sprovohet me diçka nuk duhet që të fokusohet tek ajo ngjarje por duhet që të shohë begatitë e tjera. Allahu i madhëruar thotë: "Nëse do t'i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t'i llogarisnit ato".¹²

8. Sprovat janë alarm për përmirësim. Allahu (xh.sh) thotë: "Ne i vumë në provë ata me mirësi dhe fatkeqësi, me qëllim që të ktheheshin (në rrugë të drejtë)".¹³

9. Istigfari, kërkimi i faljes. I Dërguari i Allahut, ka thënë: "Allahu, ymetit tim ia ka garantuar dy herë sigurinë dhe e lexoi ajetin: "Por Allahu nuk do t'i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe, Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij".¹⁴ Dhe pastaj tha: "Kur unë do të vdes atyre do tu mbetet istigfari".¹⁵

Hasan El-Basriu (r.h) ka thënë: "Shtojeni sa më shumë istigfarin në shtëpitë tuaja, në pritjet tuaja, në rrugë, në treg, në tubimet tuaja, ngase ju nuk dini se kur do të zbrësh falja e Allahut për ju."

I lutem Allahut që t'i mëshirojë viktimat e këtij tërmeti, t'u japë durim të afërmve të tyre dhe uroj shërim sa më të shpejtë për të gjithë të lënduarit!

9. Shih: Fet'hul Bari.

10. Kur'ani, Gafir: 60.

11. Transmetuar nga Ebu Davudi dhe Ahmedi.

12. Kur'ani, En-Nahl: 18.

13. Kur'ani, El-A'raf: 168.

14. Kur'ani, El-Enfal: 33.

15. Transmetuar nga Tirmidhiu.

TË DREJTAT E PËRGJITHSHME PËR "EHLU DHIMME", JOMYSLIMANËT

1- Mbrojtja e jetës: Jeta e jomuslimanit është si jeta e muslimanit.

2- E drejta penale është e njëjtë për muslimanin dhe jomuslimanin. Për atë krim që muslimani ndëshkohet, gjithashtu në të njëjtën mënyrë edhe jomuslimani do të ndëshkohet.

3- Kodi civil: Muslimani dhe jomuslimani, përpara këtij kodi janë të barabartë. Jomuslimani ka të drejtë të mbajë, të rrisë, të shesë dhe të hajë prej mishit të derrit. U jepet e drejta të prodhojnë, të pinë dhe të shesin alkool. Në qoftë se një musliman i dëmton një jomusliman alkoolin, ose derrin, ai duhet të paguajë dëmin e shkaktuar.¹

4- Mbrojtja e nderit dhe e personalitetit: Nuk lejohet t'i bëhet keq, as me dorë dhe as me gojë jomuslimanit. As të shahet, të fyhet, të goditet dhe as të përgojet. "Përgojimi i jomuslimanit është i ndaluar, haram, sikur përgojimi i muslimanit".²

5- Garancia e Mbrojtjes: Marrëveshja e Mbrojtjes³ i detyron muslimanët ta zbatojnë përgjithmonë atë. Nuk i lejohet asnjë musliman që ta thyejë atë, pasi ta ketë nënshkruar. Ndërsa njerëzit e "mbrojtur", ehlu dhimme, janë të lirë në zbatimin e saj, mund ta prishin kur dhe si të duan.

Personi i mbrojtur, çfarëdo krimi që kryen nuk e prish marrëveshjen, madje as edhe mospagimi i xhizjes, apo vrasja e një muslimani, nuk e thyen këtë marrëveshje (mbrojtje). Për të gjitha këto veprime, jomuslimani dënohet ose ndëshkohet sipas ligjit të krimeve të bëra. Veprimet e tij nuk konsiderohen si arrogancë ndaj shtetit dhe as nuk e përjashtojnë nga marrëveshja e mbrojtjes.

Vetëm dy gjëra ia ndalojnë të drejtën e përfutimit dhe e përjashtojnë nga marrëveshja.

E para: Në qoftë se largohet nga territoret islame dhe emigron drejt shteteve të tjera.

E dyta: Në qoftë se del hapurazi ndaj shtetit Islam dhe shkakton trazira nëpër territoret e këtij shteti.⁴

6- Çështjet civile: Jomuslimani i trajton

1. Në lidhje me këtë pikë, në librin Ed-Dur el-Muhtar, vëllimi III, faqe 273 shkruhet: "Në qoftë se muslimani i dëmton jomuslimanin alkoolin ose derrin, muslimani është i detyruar të paguajë dëmin e shkaktuar".

2. Ed-Dur el-Muhtar, 3/273-274.

3. Akdu dhimme.

4. El-Beda'iu, 7/113, Fet'hul Kadir, 4/381-382.

duke i gjykuar sipas ligjit të tij civil.

Umer ibn Abdulaziz i shkroi letër Hasan Basriut për ta pyetur: "Si ka qenë çështja e kalifëve rashidinë, të cilët kanë lejuar jomuslimanët të martohen në mënyra të ndaluara, të zotërojnë, të hanë dhe të pinë alkoolin dhe mishin e derrit?"

Hasan Basriu i kthen përgjigje duke i thënë: "Xhizja merret në shkëmbim që të lihen dhe të mos ndërhyhet në punët dhe në besimin e tyre. Ti je "muttebi la mubtedi", "pasues dhe jo shpikës". Selam".⁵

Në qoftë se dy palë prej jomuslimanëve të përfshirë në ndonjë konflikt mes tyre, dëshirojnë të gjykojnë sipas shariatit Islam, atëherë me dëshirën e tyre zbatohet gjykimi i shariatit. Por, në qoftë se njëra palë e përfshirë në konflikt, është muslimane dhe çështjen në konflikt e përfshin kodi civil, atëherë mes palëve gjykohet vetëm me shariatin Islam.

7- Simbolet fetare: Jomuslimanët janë të lirë dhe gëzojnë të drejtën të shfaqin simbolet e tyre fetare brenda dhe jashtë vendeve të adhurimit që kanë, nuk ndëshkohen. Ata janë të lirë t'i restaurojnë dhe ti rregullojnë këto vende adhurimi. Shteti Islam nuk ka të drejtë të ndërhyjë në këto çështje.

8- Lehtësimi dhe toleranca në marrjen e xhizjes dhe të taksave: Është e ndaluar të sillësh ashpër dhe me arrogancë ndaj jomuslimanëve, në marrjen e xhizjes dhe të taksave. Madje nxitet për butësi, mëshirë dhe lehtësi ndaj tyre për çdo gjë. Kushdo prej tyre që është i varfër, ose nevojtar, jo vetëm lirohet nga pagesa e xhizjes, por edhe i jepet ndihme sociale prej buxhetit të muslimanëve. Në qoftë se jomuslimani vdes dhe ai ka pa paguar xhizjen, atij nuk i merret asgjë prej trashëgimisë së tij dhe as prej trashëgimtarëve të tij, për të likuiduar xhizjen e papaguar.

Ebu Jusuf el-Kadi⁶ thotë: "Në qoftë se një jomusliman ka hyrë në të drejtën e pagimit të xhizjes dhe vdes papaguar, ose ka paguar një pjesë dhe ka mbetur pa shlyer pjesën tjetër, nuk lejohet të merret prej trashëgimtarëve dhe as prej

5. "Të drejtat e jomuslimanëve në shtetin islam", Ebu E'ala el-Mevdudi, f. 18.

6. Ai është imami muxtehid, kolosi, muhadithi, gjykatësi i gjykatësve, Ebu Jusuf, Jakub ibn Ibrahim Habib ibn Hubejsh ibn Sead ibn Buxhejr ibn Muavije El-Ensarij El-Kufij (113-182).

trashëgimisë së tij".⁷

Ibn Abidini përmend në "Hashije" se të gjithë fukahat, dijetarët ekspertë muslimanë, të të gjitha shkollave të interpretimit, ixhtihadit, kanë bërë të qartë dhe e kanë përsëritur se muslimanët kanë për detyrë të mbrojnë dhe të sigurojnë jomuslimanët ndaj çdo rreziku, apo sulmi armiqësor. Kur muslimanët u kanë siguruar mbrojtjen, atëherë janë të detyruar që t'i garantojnë të tillë mbrojtje, sepse duke u gjendur në territorin islam, ata do të quhen gjithashtu nënshkruar islam. Madje, disa dijetarë janë të mendimit se, padrejtësitë dhe zullumi ndaj jomuslimanëve është më i rëndë dhe më i dënueshëm se sa ndaj muslimanëve.

Laura Vecci Vaglieri⁸, orientaliste italiane, duke folur për marrëveshjet që muslimanët kanë nënshkruar, thotë:

"Këtyre popujve iu dha e drejta të ruajnë e të posedojnë fetë, traditat dhe zakonet e tyre të vjetra, me kusht që ata, të cilët nuk e përqafojnë Islam, t'i paguajnë një taksë të drejtë shtetit islam, që quhet xhizje. Kjo taksë ishte shumë më e lehtë se sa taksa që muslimanët ishin të detyruar t'i paguanin vetë shtetit të tyre. Në shkëmbim të kësaj takse, jomuslimanëve u siguroheshin të drejta dhe mbrojtje, të cilat nuk ndryshonin aspak nga të drejtat dhe mbrojtja që vetë muslimanët gëzonin. Kështu, vepra e Pejgamberit (a.s) dhe e kalifëve rashidinë të drejtë, u bë ligj, që muslimanët ishin të detyruar ta ndiqnin. Nuk është aspak teprim të këmbëngulim duke thënë se, Islami nuk mjaftoi vetëm me thirrjen për tolerancë fetare, por e tejkaloi këtë duke e bërë tolerancën pjesë të ligjit të tij fetar".⁹

Gustav Le Bon¹⁰ shprehet kështu rreth kësaj çështje: "Xhizja e papërfillshme, shumë më e paktë se sa taksa që paguhej ndaj padronëve të tyre të mëparshëm".¹¹

("Toleranca në Islam",
Dr. Sheuki Ebu Khalil,
përktheu nga arabishtja: Lavdrim Hamja)

7. El-Haraxh, f.70.

8. Laura Vecci Vaglieri, profesore e gjuhës arabe në Universitetin e Napolit. Ka një libër të përkthyer arabisht që titullohet "Difaun anil Islam" (Në mbrojtje të Islamit).

9. Difaun anil Islam, Laura Vecci Vaglieri, f. 34-35.

10. Gustave Le Bon (1842-1931), filozof dhe sociolog francez. Prej librave të tij të shtrenjtë është "Hadaretul arab" (Qytetërimi arab).

11. Hadaretul arab (Qytetërimi arab), Gustave Le Bon, f. 134.



Dr. Mustafa Mahmud

Këtë herë, miku ynë, ndërkohë që fjalët i përtypete me ngadalësi, ishte tepër i bindur në veten e tij se do të hidhte ndonjë bombë.

Si do të na ndëshkojë Allahu, ndërkohë që Ai është Mëshiruesi dhe Mëshirëbërësi ndaj një mëkati të kufizuar në kohë, me një ndëshkim të pakufizuar në përjetësi (Zjarri, përjetë janë të dhe përgjithmonë).

Kush jemi dhe ne dhe çfarë vlejme në krahasim me madhësinë e Allahut, derisa të hakmerret ndaj nesh me këtë lloj hakmarrije?

A, nuk është njeriu, veçse një grimcë atomi apo një grimcë pluhuri në univers dhe ai në krahasim me Lartmadhërinë e Allahut është shumë më i pavlerë se sa kjo, madje nuk është asgjë përpara Tij!

Ne, ia korrigjojmë të dhënat doktorit dhe themi.

Së pari, ne nuk jemi grimcë atomi as grimcë pluhuri në univers. Vlera jonë tek Allahu nuk e vogël, madje është e madhe.

A, nuk ka fryrë në ne prej shpirtit të Tij?

A, nuk i ka urdhëruar melekët të na bëjnë sexhde?

A, nuk na ka premtuar për trashëgiminë e qiejve dhe të tokës, duke thënë për ne: “Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit dhe i kemi mbartur në tokë dhe në det, e i kemi furnizuar prej të mirave dhe i kemi dalluar tepër ndaj shumë atyre që kemi krijuar”. – (Kur’ani, El-Isra: 70)

Ne, pra kemi prej shpirtit të Allahut.

Ne, përkundrejt universit, nuk jemi grimcë atomi apo grimcë pluhuri.

Ne, duke parë trupin tonë dukemi si grimcë atomi apo grimcë pluhuri në krahasim me universin e madh e të gjerë.

Por, a nuk e përfshijmë këtë univers dhe e perceptojmë me mendjen tonë, e i kuptojmë ligjet e tij dhe të galaktikave,

XHENETI DHE ZJARRI

dhe, çdo planeti ia skicojmë orbitën e tij?

Pastaj, astronauti i hapësirës zbrit në hënë dhe zbulon, se të gjithë atë, që ne e kishim perceptuar me mendjen tonë në tokë ka qenë e vërtetë.

Dhe, çdo gjë që kishim skicuar ka qenë e tillë deri në detaje.

A, nuk tregon kjo gjë, se ne duke vështruar në shpirtin tonë jemi më të mëdhenj se universi dhe se ne e përfshijmë atë, e poeti ka qenë në të drejtën kur i është drejtuar njeriut me këto fjalë: “Mendon, se ti je masë e vogël – ndërkohë tek ty është palosur (mbledhur) bota më e madhe”.

Njeriu, siç e thonë sofistët (gnostikët), është libri gjithëpërfshirës dhe universi janë fletët e tij.

Pra, njeriu është gjë e madhe dhe me rëndësi të lartë.

Ai është prej shpirtit të Allahut.

Veprat e tij e detyrojnë llogaridhënien.

Ndërsa, për sa i përket mëkatit të kufizuar në kohë, për të cilin Allahu na ndëshkon me dënim të pakufizuar, përgjithmonë.

Ky është një gabim tjetër, në të cilin ka rënë doktori ynë i shtrenjtë, i bindur në veten e tij.

Allahu thotë për këta tipa të përjetësuar në zjarr, ndërkohë që kërkojnë të kthehen në dynja për të punuar diçka tjetër nga ajo që kanë punuar.

Allahu i Madhëruar thotë: “E, sikur të kthehen, do t’i riktheheshin edhe një herë asaj për të cilën janë ndaluar. Ata janë gënjeshtarë”. – (Kur’ani, El-En’am: 28)

Pra, mëkati i tyre nuk është mëkat i kufizuar në kohë, por ai është tipar i pandryshuar, që do të përsëritet në çdo kohë.

Sikur të kthehen, do t’i riktheheshin mëkateve të tyre dhe ata janë gënjeshtarë.

Kjo pra, është një faqe e përhershme në shpirt dhe jo diçka e rastësishme në një situatë kalimtare në dynja.

Ai (xh.sh) thotë për ta në një vend tjetër: “Ditën, kur Allahu do t’i ringjall të gjithë dhe do t’i betohen Atij, ashtu siç ju betohen juve, e mendojnë se janë në diçka... a, nuk janë ata, me të vërtetë gënjeshtarë?” – (Kur’ani, El-Muxhadele: 18)

Kjo është një pamje tjetër e

këmbënguljes dhe e sfidës, arrin deri aty sa ata përballen me Allahun me gënjeshtria dhe betohen rrejtshëm, ndërkohë që ata janë përpara duarve të Tij, ditën e qëndrimit të madh, ditën që ngrihet perdja dhe zbulohet mbulesa.

Kjo është kryelartësi dhe mendjemadhësi e paparë.

Këtu nuk jemi përpara një mëkati të kufizuar në kohë, por madje përpara një mëkati të vazhdueshëm në kohë, edhe pasi që koha jonë të zhduket e çdo kohë tjetër.

Ne këtu jemi përpara një qenie që mbart me vete të keqen e saj në përjetësi.

A, nuk është njeriu, veçse një grimcë atomi apo një grimcë pluhuri në univers dhe ai në krahasim me Lartmadhërinë e Allahut është shumë më i pavlerë se sa kjo, madje nuk është asgjë përpara Tij!

Nga këtu, del se ndëshkimi i përjetshëm për këtë qenie, është drejtësi.

Për këtë arsye, thotë për ta ajeti me shumë qartësi: “Ata, asnjëherë nuk kanë për të dalë nga zjarri”. – (Kur’ani, El-Bekare: 167)

Ibn Arabiu thotë: Mëshira për këta njerëz të tillë është, se ata do të ambientohen me zjarrin dhe ky zjarr i përjetshëm dhe i përhershëm bëhet mjedisi i tyre i përshtatshëm.

Nuk ka dyshim, se ka një përputhje mes disa shpirtave keqbërës dhe mes zjarrit. Disa prej këtyre shpirtave, ato në realitet janë shkëndijë zjarri smire, urretjeje, epshi, xhelozie, mashtrimi, zjarr zemërimi, mallkim, shfryrje dhe ndjenja keqbërëse të ndezura fort, sikur ato të jenë zjarr me të vërtetë.

Shembulli i këtyre shpirtave nuk mundet të jetojë në paqe, nuk mundet të jetojë qoftë edhe për një moment pa ndezur përreth saj luftë dhe pa ndezur

zjarr të fortë përreth tyre, sepse zjarret janë mjedisi dhe natyra e tyre.

Shembulli i këtyre shpirtave, qëndrimi i tyre në zjarr është vendimi drejtë dhe ky përfundim është prej llojit të vendosjes së gjërave në vendin e tyre.

Sikur ata të hynin në xhenet, nuk do ta kishin shijuar atë.

A, nuk e kanë refuzuar paqen në tokë?

Duhet ta kuptojmë zjarrin dhe xhenetin në ahiret, me një kuptim me horizont të gjerë.

Zjarri në ahiret nuk është pjekje. Ajo që i ndodh atij, nuk është djegia me kuptimin e dynjasë, sepse Allahu thotë për mëkatarët se flasin dhe mallkojnë njëri-tjetrin dhe se zjarri, në të ka pemë, që ka fruta.

Ajo është pema “zakumit”, e cila del prej fundit të xhehenemit. Ashtu siç ka edhe ujë të nxehtë, prej të cilit pinë të ndëshkuarit.

Një zjarr i tillë, në të cilin është pema e “zakumit”, ka ujë dhe njerëzit flasin në të, patjetër që është zjarr tjetër: “Sa herë që hyn një popull (turme) mallkon simotrën e saj, derisa të hynë të gjithë në të, turma e fundit i thotë të parës: Zoti ynë, këta janë ata, të cilët na kanë humbur, prandaj dyfishoja dënimin e zjarrit. Thotë: Secili e keni të dyfishuar, por ju nuk e dini”. – (Kur’ani, El-Araf: 38)

Ata flasin, ndërkohë që ata janë në zjarr dh, ai është zjarr: “Lënda e të cilët janë njerëzit dhe gurët”. – (Kur’ani, El-Bekare: 24)

Ky zjarr, pra është prej llojit të fshehtës (gajbit).

Nuk duhet të kuptohet në asnjë mënyrë nga kjo fjalë, se ne e mohojmë ndëshkimin e prekshëm (trupor) dhe themi vetëm për ndëshkimin ndjesor.

Sepse, ndëshkimi i prekshëm (trupor) është tepër i qartë dhe nuk lejohet të dyshohet në të dhe ne besojmë për ekzistencën e tij.

Por, themi se detajet e këtij ndëshkimi dhe mënyra e tij, ashtu si edhe natyra e këtij zjarri dhe vetitë e tij të hollësishme, janë gjëra të fshehta (gajb) dhe të panjohura. Ky zjarr, siç duket prej shenjave treguese kur’anore të tij është zjarr i ndryshëm nga zjarri (jonë).

Ashtu si edhe trupat tonë në përballimin e atij zjarri janë të ndryshëm prej trupave tanë nga dheu i shkrifët.

E njëjta gjë edhe për xhenetin, ai nuk është treg zarzavatesh, perimesh, shega e rrushit, por ato përshkrimet kur’anore, janë thjesht shenja treguese, shembuj

dhe përafrim për mendjet tona.

“Shembulli i xhenetit, i cili u është premtuar të devotshmëve, në të ka lumenj prej uji qelibar dhe lumenj prej qumështi, që nuk i ndryshon shija e tij”. – (Kur’ani, Muhammed: 15)

“Shembulli i xhenetit”, pra ne sjellim shembull, për t’u afrua kuptimi i xhenetit tek ti, por e vërteta është, se detajet janë të fshehta (gajb).

“Askush nuk e di, se çfarë i është fshehur prej kënaqësisë së syrit, si shpërblim për atë që kanë vepruar”. – (Kur’ani, Es-Sexhde: 17)

“Xhenet, gjerësia e tij, janë qiejt dhe toka”. – (Kur’ani, Ali Imran: 133)

Ai, nuk mund të jetë thjesht një kopsht.

“Dhe, fruta të shumta, që nuk mbarojnë e as nuk janë të ndaluara”. – (Kur’ani, El-Vakia: 32-33)

Ato janë të ndryshme prej frutave tona, që mbarojnë dhe janë të ndaluara... dhe verë:

“Që nuk i turbullon e as nuk ua merr mend” (nuk dehen prej saj). – (Kur’ani, El-Vakia: 19)

Ajo është e ndryshme prej verës sonë, e cila na i merr mend (na deh) dhe na turbullon mendjen.

Kur’ani thotë për banorët e xhenetit: “Dhe, ua kemi hequr nga kraharorët e tyre, urretjen e smirën”. – (Kur’ani, El-Hixhr: 47)

Këtu shpirtat (qeniet) janë pastruar me një mënyrë, që nuk e dimë.

Xheneti, pra është edhe ky i fshehtë (gajb) dhe nga kjo fjalë nuk ka asnjë lloj mohimi të kënaqësive trupore, sepse ne besojmë, se xheneti është kënaqësi trupore dhe shpirtëror së bashku, ashtu si zjarri, që është trupor dhe shpirtëror, por ajo që kërkojmë ta theksojmë është, se detajet e kësaj kënaqësie apo të ndëshkimit dhe mënyra e tyre është e fshehtë (gajb), e panjohur.

Se, xheneti nuk është treg frutash e perimesh dhe as zjarri nuk është furrë për pjekje mishi.

Ndëshkimi në ahiret nuk është mendjemadhësi nga Allahu ndaj robërve të Tij, por ai është pastrim, njohje, korrektim dhe mëshirë.

“Çfarë do të bëjë Allahu me ndëshkimin tuaj, nëse falënderoni dhe besoni”. – (Kur’ani, En-Nisa: 147)

Origjina (baza) është mos ndëshkimin.

Allahu nuk ndëshkon atë që e njeh dhe i beson, por Ai e hedh ndëshkimin e Tij ndaj mohuesit dhe mosbesimtarit,

me të cilin kanë dështuar të gjitha mjetet e udhëzimit, të njohjes dhe të kuptuarit.

“Ne, patjetër do t’i bëjmë të shijojnë ndëshkimin më të vogël, përpara ndëshkimit më të madh, ndoshta ata kthehen”. – (Kur’ani, Es-Sexhde: 21)

Praktika e Allahut, që këtyre të tillëve t’i bëjë të shijojnë ndëshkimin më të vogël në dynja për t’i zgjuar prej hutimit (gafletit) të tyre dhe për t’i tronditur prej këtij gjumi dhe mosveprimi... “ndoshta ata kthehen”.

Nëse nuk kanë sukses të gjitha mënyrat dhe mohuesi qëndron në mohimin e tij, atëherë nuk mbetet gjë tjetër, veçse të përballet me ndëshkimin e vërtetë për ta njohur Atë.

Njohja e të vërtetës, është vetë mëshira.

Sikur Allahu t’i linte ata në verbërinë dhe injorancën e tyre, e t’i neglizhonte, kjo do të ishte zullum prej Tij. I pastër dhe i pa të meta pafundësisht është Ai prej gjithë kësaj. Ballafaqimi me zjarrin për këta tipa të tillë injorantë është përkujdesje.

Dhe, të gjitha punët e Allahut janë mëshirë.

E mëshiron injorantit me xhehenem, si edukim dhe mësim për të.

E mëshiron njohësin (besimtarin) me xhenet, si mirësi dhe nderim për të.

“Ndëshkimi Im, që godas me të kë të dëshiroj dhe mëshira Ime ka përfshirë çdo gjë”. – (Kur’ani, El-Araf: 156)

Ka bërë, që mëshira e Tij ka përfshirë çdo gjë, deri edhe ndëshkimin.

Pastaj, na lini të pyesim doktorin.

A, është Allahu më i drejtë në vështrimin e tij, nëse Ai barazon mes zullumqarëve dhe të shtypurve, e mes gjakpirësve dhe viktimave të tyre, e secilin e shpërblen në ahiret?

A, është e drejtë në vështrimin e doktorit të barazohet i bardhi me të ziun? Dhe, ata të cilët largohen nga Allahu, që t’i ndëshkojë, thonë: A, nuk po na ndëshkon me të vërtetë Allahu në dynjanë tonë?

E, çfarë është pleqëria, sëmundja dhe kanceri, përveçse vetë ndëshkimi.

Kush i krijoi mikrobet?!

A, nuk janë të gjitha këto tërheqje vëmendjeje, se ne jemi përpara një Zoti, që mund të na ndëshkojë?

(Marrë nga libri: DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

"OSMANLINJTË NUK RRËNUAN DHE NUK DOGJËN, POR NDËRTUAN" FLET AUTORJA E ROMANIT "EZAN"

Romani "Ezan", i shkrimtares së shpërblyer nga Osijeku i Kroacisë, Ivana Shojat, u kthye në historinë e largët të shekullit të 16-të, në periudhën e Sulejmanit të Madhërisë, kur Perandoria Osmane përjetoj kulmin e saj kulturor dhe territorial. Personazhi kryesor i romanit është Ibrahim, i cili në fund të jetës së tij i rrëfen djalit të tij, duke shikuar në të kaluarën dhe jetën e tij. Ibrahim dikur ishte Luka, një djal që u dorëzohet turqve në devshirme, i cili dërgohet m'u në qendër të Perandorisë së madhe Osmane, ku Ibrahim bëhet jeniçer.

Romani "Ezan", i shkrimtares së shpërblyer nga Osijeku i Kroacisë, Ivana Shojat, u kthye në historinë e largët të shekullit të 16-të, në periudhën e Sulejmanit të Madhërisë, kur Perandoria Osmane përjetoj kulmin e saj kulturor dhe territorial. Personazhi kryesor i romanit është Ibrahim, i cili në fund të jetës së tij i rrëfen djalit të tij, duke shikuar në të kaluarën dhe jetën e tij. Ibrahim dikur ishte Luka, një djal që u dorëzohet turqve në devshirme, i cili dërgohet m'u në qendër të Perandorisë së madhe Osmane, ku Ibrahim bëhet jeniçer.

Duke pasur parasysh terma të shumta nga ajo kohë, të cilat Shojat në këtë roman i "ripërcakon" nga negative në pozitive dhe anasjelltas, hyrja në këtë temë sigurisht ishte e rrezikshme dhe kërkohen shumë informacione, ashtu që autorja të mos bie në atë që e quan falsifikim, diçka e shpikur dhe prodhim të mitologjive të reja. Prandaj, përveç letërsisë, ajo është konsultuar me miqtë e saj dervishë dhe miq të tjerë të cilët e njohin temën e Islamit dhe historinë e rajonit nga kjo perspektivë. Nëpërmjet rrjeteve sociale ajo mori mijëra fotografi të vendeve ku zhvillohet ngjarja e romanit të saj.

"Mitizimi është puna më e shëmtuar që i ndodh njerëzimi në vazhdimësi, e cila atë, pra palën tjetër, që nuk jemi ne, e shndërron në një përbindësh. Ndërkaq, kam kërkuar që t'i shmangem kurthit për të kaluar në ekstremin tjetër", thotë Shojat në një prononcim për Anadolu Agency (AA).

KOCKA NGA VARREZAT TURKE SI NJË FRYMËZIM PËR ROMANIN

Djali Luka nga Ostrozhaci i Hercegovinës, pranë Jabllanicës, në fillim të tregimit dhe rrëfimit të Ibrahimit për të birin, udhëton larg në lindje, në Stamboll, dhe në fund të romanit kthehet në varrezat turke në Sllavoni, pranë Danubit, ku pas zbulimit të eshtrave të njeriut, filloi frymëzimi i vërtetë i autorit.

Shkrimtarja Shojat disa vjet më parë, gjatë shoqërimit me kolegët, mbrojtësit

e atdheut (ushtarët kroatë), diku në fushën e Sllavonisë midis Erdutit dhe Almashit, nga një koleg u paralajmërua se pikërisht ndodhen në vendin që dikur ishin varrezat osmane.

"Mora një lopatë ushtarake dhe fillova të gërmoj, dhe isha me fat, gjeta një copë të kockës të këmbës të njeriut. Këtë pas analizës ma konfirmoi një mik patolog i cili tha se kocka është e vjetër të paktën 300 vjet" thotë Shojat.

Duke menduar, pjesërisht duke imagjinuar fatin e mundshëm të ish "pronarit" të kockës së gjetur, autorja Shojat filloi të shkruajë historinë e këtij romani.

Shojat thotë se ishte e inkurajuar të shkruajë romanin "Ezan" me një temë të tillë specifike nga dy këndvështrime:

"Këndvështrimi i parë është se

"Ne vazhdimisht e prezantojmë Perandorinë Osmane si diçka që erdhi tek ne për të djegur dhe shembur. Perandoria Osmane ka ndërtuar. Janë ndërtuar ura mbi lumenj që deri në ardhjen e turqve në rajonin tonë nuk kanë qenë të kalueshme, por janë përdorur ekskluzivisht skela ose diçka të ngjashme për të kaluar përtej lumit. Ata ndoqën romakët dhe vazhduan të ndërtojnë. Romakët ndërtuan rrugë mbi të cilat ne sot kemi shtruar asfalt", tregon autorja e romanit "Ezan".

ngjarjet historike gjithmonë shihen njëanshëm, e cila u shkon për shtati disa grupeve të njerëzve dhe mitologjistëve. Shpesh harrohet se sa i përgjakshëm ishte shekulli i 16-të, jo vetëm për shkak të Perandorisë Osmane, por edhe për shkak të reformimit dhe kundër-reformimit që po ndodhte. Ishte një kohë e masakrës së madhe mes të krishterëve, të cilën shpesh e harrojmë".

Këndvështrimi i dytë i autores për romanin është motivimi për pjesën mistike e cila e inkurajon shkrimtaren.

DEVSHIRMA, MARRJA PENG SI METODË E ARRATISJES NGA ROBËRIA

Rrëfimet e kryeheroit Ibrahim në shtratin e vdekjes në romanin "Ezan" fillojnë me kujtimet se si duke qenë djalosh merret në devshirme. Ajo përshkruan në mënyrë shumë emocionale ndarjen me nënën e tij, dhe pastaj edhe mbërritjen në qendrën e Perandorisë Osmane, ku i vendoset emri Ibrahim, ndërsa me vetë aktin e sunetit, Luka pushon të jetë më një i krishterë.

Marrja peng nëpër tërë historinë e letërsisë kroate, por edhe në letërsinë e popujve tjerë të rajonit, gjithmonë portretizohet si rrëmbimi i dhunshëm i fëmijëve nga prindërit e tyre, si një akt i tmerrshëm dhe i pashpirt të pushtuesve osmanë, por Shojat në romanin e saj ofron një pamje krejtësisht të ndryshme:

"Sa më shumë kalonte koha, kjo për devshirmët ishte një mundësi e madhe pasi që fëmijët ishin lindur në feudalizëm, në anën krishtere, ishin bujkrobër nga familjet bujkrobërishe, të gjykuar të qëndrojnë aty. Nuk ka pasur zhvillime, mënyrë për të përparuar, pavarësisht aftësisë dhe shkathhtësisë të tyre. Thjesht, ke lindur i tillë dhe kështu do të qëndroje deri në vdekje. Fëmijët që përfundonin në devshirme, marrja peng, dhe që do të shkonin në disa vende rreth Stambollit, ku do të merrnin arsimin bazë – vazhduan të zhvillohen, u shkolluan, ndërsa në disa raste edhe arritën deri në pozita të larta. Kemi disa vezirë që janë nga zonat tona".

OSMANLINJTË VAZHDUAN TË NDËRTOJNË MBI ROMAKËT

"Gjatë gjithë historisë, në shkollën kemi mësuar se kufijtë që lindin mes qytetërimeve në zgjerimin dhe ata që e mbrojnë veten janë të forta si një gardh i gurit, kjo nuk është e vërtetë. Këta kufij janë të depërtueshëm,... Nuk ka asnjë kufi që do të ndalte tregtarët, kultura vazhdon të shkëmbehet. Ne duam të themi se kemi qenë një mburojë e krishterimit, por në fakt Islami dhe Krishterimi kanë komunikuar vazhdimisht, me vetëdije apo pa vetëdije, përmes gërshetimit të kulturave", thotë Shojat.

Një nga mitet më të zakonshme në lidhje me pushtimin osman dhe ndëshkimin e të pabindurëve në letërsi shpesh është përdorur "ngulitja në hu", për çka autorja e pohon se është një gënjeshtër historike dhe se kjo në të vërtetë është një zakon i ndëshkimit që vjen nga banorët e lashtë në Ballkan, vllëhet.

"Ne vazhdimisht e prezantojmë Perandorinë Osmane si diçka që erdhi tek ne për të djegur dhe shembur. Perandoria Osmane ka ndërtuar. Janë ndërtuar ura mbi lumenj që deri në ardhjen e turqve në rajonin tonë nuk kanë qenë të kalueshme, por janë përdorur ekskluzivisht skela ose diçka të ngjashme për të kaluar përtej lumit. Ata ndoqën romakët dhe vazhduan të ndërtojnë. Romakët ndërtuan rrugë mbi të cilat ne sot kemi shtruar asfalt", tregon autorja e romanit "Ezan".

Ajo konsideron se kultura vendore tenton të tregojë të ardhurit si një lloj të errësirës që gllabëron gjithçka dhe se para ardhjes së tyre ka qenë më mirë ndërsa autorja e sheh nevojën e ridefinimit të kësaj dhe vetes tonë.

Në Sllavoni nuk mbeti asnjë xhami pas tërheqjes të Osmanlinjëve, thotë Shojat, ndërsa ishin 5 xhami:

"Kaq për tolerancën. Le të jemi të sinqertë me veten", porositi lexuesit e saj.

Për autoren, Sulejmani i Madhërisë, është një figurë e rëndësishme që shfaqet në romanin "Ezan", një figurë historike që meriton vëmendje, sepse ajo beson se një shtrirje e tillë e Perandorisë Osmane nuk mund të arrinte dikush që nuk kishte një konisderatë të thellë të personalitetit dhe edukimit.

"Më vjen keq që herë pas here e shtrembërojnë", thotë shkrimtarja Shojat.

"Sulejmanin e kam përjetuar si një personalitet kompleks, i cili sikur të

ketë qëndruar në dy dhoma. Ai është një poet dhe një i dashuruar që shkruan poezi, në anën tjetër është një luftëtar i pamëshirshëm, njeriu që fiton, i cili nuk heq dorë, i cili ngacmonte Vjenën. Ai ishte një sundimtar jashtëzakonisht inteligjent dhe i zgjuar, pa mëshirë edhe ndaj fëmijëve të tij, të cilët nuk i fal, nëse dëshirojnë ta shembin botën e tij", thotë autorja e romanit Ezan.

Fushëbeteja pas luftës kundërmon

Autorja Shojat ka një përvojë pasi ka qenë pjesëmarrëse e luftës së fundit në Kroaci, e cila ka shërbyer në mbrojtje të Osijekut.

"Dua të heq maskën nga lufta. Të gjitha mitologjitë nacionale dhe të tjera duan të rrisin trimërinë dhe heroizmin në fushëbetejë, duke injoruar plotësisht realitetin. Njeriu kur është i plagosur, ai është i pafuqishëm, atij nuk i bien ndërmend fjalë të mëdha, ai nuk dërgon mesazhe të mëdha. Kam parë shumë njerëz që ishin pranë meje të plagosur, disa janë shëruar, disa kanë vdekur. Nuk mbaj mend se ndonjëri prej tyre tha diçka mbresëlënëse, asgjë të rëndësishme. Këtu ka dhimbje, thërritet nëna, ka të qara, këto janë momente në të cilat nuk mund të kontrollohen", thotë Shojat.

"Fushëbeteja pas luftës kundërmon erë të keqe, ajo mbetet me kufoma të gjymtuara. Vijnë grabitqarët dhe hajdutët, këtu nuk ka asgjë të bukur. Nëse koha është me diell, për disa orë ajo fillon të kundërmon erë të keqe dhe mbushet me miza", shtoi ajo.

Për sa kërkon që përpiqet të gjejë një të vërtetë tjetër rreth ngjarjeve historike, po ashtu edhe personazhet e romanit "Ezan" e bëjnë këtë duke treguar papërsosmërinë njerëzore. Gruaja e dashur e Ibrahimit, Vasilis u rrit si një ortodokse dhe kurrë nuk e braktisi Profetin Isa, edhe pse burri i saj ishte një musliman.

"Dashuria e tij për Vasilisën nuk ka gardh, sepse për dashuri nuk ka rëndësi as dallimi kulturor, as fetar, as gjuhësor, as ndonjë dallim tjetër", thotë autorja.

E pyetur nëse ajo sheh stilin e saj të letërsisë dhe afërsinë tematike me Ivo Andriç ose Ivana Aralica, Shojat thotë se ajo në fakt ka më shumë afërsi me Meshu Selimoviç, i cili, sikurse ajo, i qaset më shumë nivelit metafizik, sepse edhe pse shkrimi është i bazuar në qasjen historike, vazhdimisht kërkon disa shkëmbime shpirtërore.

(www.ina-online.net)



"Kur'ani

na e ka paraqitur

besimin të trupëzuar

në vepra, në moral

dhe në qëndrime,

për të qenë pasqyrë,

ku secili njeri

sheh veten e tij:

Çfarë ka marrë

prej tij dhe çfarë

ka lënë pa bërë?"

Dr. Jusuf El-Karadavi

DIJETARËT E SHQAR TË ISLAMIT NË IRAK EBU HANIFE EN-NU'MAN DHE MEDHHEBI HANEFI

Ebu Hanife En-Nu'man ibn Thabit nga Kufja, ishte një dijetar i shquar musliman. Ai është i pari ndër katër dijetarët e shquar që themeluan katër shkollat e Fikhut-Jurisprudencës Islame, që përfaqësojnë Islamit Sunit. Ai është themeluesi i Medhhebit Hanefi, dhe u bë i njohur për diturinë e tij të gjerë dhe për virtutet e tij të larta.

Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë, pati thënë për Imam Ebu Hanifen: "Kush dëshiron të zgjerohet në shkencën e Fikhut, le të shikojë në librat e Ebu Hanifes, sepse atij i është dhënë suksesi në këtë shkencë."

Imam Ahmed ibn Hambel, kishte thënë: "Ebu Hanifja, përta i përket diturisë, devotshmërisë, asketicizmit, dhe dhënies përparësi Ahiretit, është në një pozicion që nuk e arrin dot askush. Është rrahur me shkopinj vetëm që të punonte për Mansurin (kalifin e asaj kohe), dhe nuk ka pranuar, Mëshira e Allahut dhe kënaqësia e Tij qofshin mbi të!"

Jahja ibn Said El-Kattan, ndër dijetarët më të shquar shkencës së "Xherh vetadil", ka thënë për Ebu Hanifen: "Ebu Hanifja- për Zotin – është më i dituri i këtij ymeti, për çështjet që sillen rreth Allahut dhe të Dërguarit të Tij."

Hasen ibn Ismail tregon se babai i tij i kishte thënë: Isha tek Rashidi (kalifi Harun Er-Reshid) kur aty hyri Ebu Jusufi (nxënës i Ebu Hanifes), dhe Haruni i tha: "M'i përshkruaj virtutet e Ebu Hanifes!" Ebu Jusufi tha: "Për Zotin, ai qëndronte shumë larg ndalesave të Zotit dhe u shmangej njerëzve që e dashurojnë jetën e kësaj bote. Ai njihej për heshtjen e gjatë dhe për të menduarit e vazhdueshëm. Nuk e kishte zakon të bënte shaka, as të fliste shumë, e kur pyetej për ndonjë çështje për të cilën kishte dituri, përgjigjej. O prijësi i

1. Marrë nga libri: "Ebu Hanife En-Nu'man", i Imamit të shquar shqiptar Vehbi Sulejman Gavoxhi, Allahu e mëshiroftë!

besimtarëve, unë e kam njohur atë vetëm si një person që e ruan veten dhe fenë e vet, merrej me veten jo me njerëzit, dhe gjithkënd e përmendte vetëm për mirë."

Pas këtyre fjalëve, Rashidi tha: "Këto janë virtutet e njerëzve të mirë."

KUSH ISHTE EBU HANIFJA

Ebu Hanife ishte emri me të cilin njihej ky dijetar i shquar i Islamit, ndërsa emri i tij i vërtetë është En-Nu'man ibn Thabit ibn El-Merzuban. Me origjinë ishte nga vendet e Persisë, nga Kabuli, kryeqyteti i Afganistanit. Familja e tij ishte një familje e respektuar. Gjyshi i tij, Merzubani, hyri në fenë islame në kohën e kalifit Omer (r.a), pastaj erdhi në Kufe, në Irak, dhe aty u vendos të banonte.



Ngjyra e gjelbër e hapur tregon përhapjen e Medhhebit Hanefi në botën islame

Sipas shumicës së dijetarëve, Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë), lindi në Kufe, në vitin 80 të hixhretit (699 kalendari jonë).

Nipi i Ebu Hanifes, Ismaili ibn Hamad, tregon se kur Thabiti, babai i Ebu Hanifes, kishte qenë i vogël, kishte shkuar tek Ali ibn Ebi Talib, i cili asokohe ishte kalif i muslimanëve, me seli në Kufe. Aliu, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, kishte bërë dua për Thabitin, që ky të ishte i bekuar bashkë me pasardhësit e tij, dhe ne, - thotë Hamadi, - shpresojmë që Allahu i Lartëmadhërisëm t'i jetë përgjigjur lutjes së Ali ibn Ebi Talib (r.a).

Në lidhje me fjalët e Hamadit, nipit të Ebu Hanifes, Ebu Abdullah ibn Ahmed ibn Kidam, thotë: "Dhe vërtetë, Allahu i është përgjigjur lutjes së Aliut (r.a), pasi Ai i Madhërisimi bëri që halifet e tokës, mbretërit e horizonteve të gjera, dhe

2. Imam Dhehebi, "Virtutet e Imam Ebu Hanifes dhe të dy ndjekësve të tij".

shumica e muslimanëve të jenë ndjekës të mësimëve të tij në Fikh-Jurisprudencën Islame."³

Ebu Hanife u rrit dhe u edukua në Kufe të Irakut, në gjirin e një familjeje muslimane, të respektuar, të pasur dhe të ndershme. Mesa duket, ai ka qenë fëmijë i vetëm i prindërve të tij. I ati ishte tregtar pëlhurash dhe rrobash, të cilat i shiste në dyqanin e tij, në Kufe, profesion të cilin e trashëgoi edhe i biri, Ebu Hanifja.

Ebu Hanifja e kishte mësuar Kur'anin e Bekuar që në moshë të vogël, siç bënin të gjithë moshatarët e tij inteligjentë asokohe, por mesa duket, ai nuk mori pjesë në ligjërat e dijetarëve që ata i mbanin nëpër qendrat e tyre, por qëndronte me të atin në dyqan, derisa i qëlloi të takohej me Sha'biun, një dijetar i kohës, takim i cili u bë shkak për hapjen e derës së një mirësie të madhe për imam Ebu Hanifen, Allahu e mëshiroftë.

Ebu Muhamed El-Harithij tregon se Imam Ebu Hanifja kishte thënë: "Kalova një ditë nga Sha'biu, i cili po rrinte ulur. Ai

më thirri, e më tha: Me çfarë merresh në kohën e lirë?". Unë, - thotë Ebu Hanife, - i thashë: "Shkoj tek filani." Ai më tha: "Nuk e kam fjalën për tregun, por për prezantimin në ligjëratat e dijetarëve".

Unë i thashë: "Nuk sillem shumë andej nga ata".

Ai më tha: "Mos vazhdo kështu, por hidhi sytë nga dituria dhe qëndrimi me dijetarët, sepse shikoj zgjuarsit dhe gjallëri tek ti."

Ebu Hanifja vazhdon: "Fjalët e tij më zgjuan diçka në zemër, dhe e lashë e nuk shkova më në treg në kohën time të lirë, por iu drejtova diturisë, dhe vërtetë, Allahu i madhërisëm më solli dobi nga fjalët e tij."

Ebu Hanifja kishte treguar: "Në vitin 96 të hixhretit shkova në Haxh, bashkë me tim atë; unë atë kohë isha 16 vjeç.

3. Marrë nga libri: "Ebu Hanife En-Nu'man", i Imamit të shquar shqiptar Vehbi Sulejman Gavoxhi, Allahu e mëshiroftë!

Atje na rastisi të shikonim një plak rreth të cilit ishin mbledhur njerëzit. Unë i thashë babait tim: Kush është ky plak? Ai më tha: "Ky burrë është një nga shokët e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, dhe quhet Abullah ibnul-Harith ibn Xhez Ez'zubejdi. Unë i thashë babait tim: "Çfarë u jep ai njerëzve, që i mblidhen ashtu rrotull?" Ai më tha: "Ai ka hadithe që i ka dëgjuar nga Profeti (a.s)". Unë i thashë: "Më çu tek ai!"

Babai im doli përpara meje duke ma hapur rrugën përmes njerëzve, derisa u afrova pranë tij, dhe e dëgjova të thoshte: I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: "Kush pajiset me dituri të fesë së Allahut, Allahu ia largon shqetësimin, dhe i jep të mira prej nga nuk e pret."⁴

AMBJENTI NË TË CILIN EBU HANIFJA U BRUMOS

Qyteti i Kufes, vendlindja e imam Ebu Hanifes, ishte njëri prej dy qyteteve më të mëdha të Irakut në atë kohë. Iraku, qysh më parë, ishte vendi i komuniteteve, i feve dhe i rrymave të ndryshme të mendimit, sepse ishte shtëpia e qytetëtimeve antike. Asirianët ishin përhapur kudo në Irak, dhe kishin themeluar shkollat e tyre aty, qysh përpara Islamit. Në shkollat e tyre studjohej filozofia greke dhe urtësia persiane. Gjithashtu, para Islamit në Irak kishin ekzistuar edhe shkollat e fesë së krishterë, në të cilat diskutohej për çështje të besimit.

Pas Islamit, Iraku konsistonte në një përzierje kombësish të ndryshme, e si rrjedhojë aty kishte edhe trazira, fitne, mendime kontradiktore në politikë dhe në bazat e besimeve. Nga vetë ndjekësit e Islamit, aty gjendeshin sekte të ndryshme si shiitët, muatezilët, havarixhët, e gjithashtu aty ishin edhe ata që njihen si Tabiin-ndjekës të Sahabeve të të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dhe të cilët mbartnin diturinë që e kishin marrë drejtpërdrejtë nga ata Sahabe me të cilët ishin takuar.⁵

Kur Ebu Hanife filloi të kuptonte nga kjo botë, ai e gjeti veten mes kësaj jete, ku vlonin mendimet e ndryshme, dhe pasi mendja e tij u poq, ai arriti t'i kuptonte secilin nga këndvështrimet e rrymave të ndryshme. Siç e thamë edhe më sipër, ai fillimisht më shumë merrej me tregti, dhe nuk përzijej shumë me

4. Marrë nga libri: "Ebu Hanife En-Nu'man", i Imamit të shquar shqiptar Vehbi Sulejman Gavoxhi, Allahu e mëshiroftë!

5. Muhamed Ebu Zahra, "Ebu Hanife".

IMAM SHAFIU, ALLAHU E MËSHIROFTË, PATI THËNË PËR IMAM EBU HANIFEN: "KUSH DËSHIRON TË ZGJEROHET NË SHKENCËN E FIKHUT, LE TË SHIKOJË NË LIBRAT E EBU HANIFES, SEPSE ATIJ I ËSHTË DHËNË SUKSESI NË KËTË SHKENCË."

dijetarët, derisa u takua me Shabiun, siç e përmendëm më sipër.

Pas këshillës së Sha'biut, Ebu Hanife iu drejtua diturisë, e filloi të shkente në rrethet e dijetarëve. Rrethet e diturisë në atë kohë ishin tri llojesh: Rrethe shkencore për studimin e Bazave të Besimeve ku përfshihej edhe Shkenca e Fjalës dhe Ploemikës (dhe në këto lloj rrethesh merrnin pjesë njerëz të komuniteteve të ndryshme), Rrethet për Studimin e Haditheve Profetike, dhe Rrethe për Fikhun-Jurisprudencën Islame.

Burimet tregojnë se Ebu Hanifja së pari u tërhoq nga rrethet ku studjohej Shkenca e Fjalës dhe Polemika me grupacionet e ndryshme, por më pas e la atë rreth, për t'i kthyer Fikhut Islam⁶.

Një transmetim i ardhur nga Ebu Jusuf (nxënësi i Ebu Hanifes) tregon se Ebu Hanife u pyet: "Si u binde të ndiqje studimin e Fikhut Islam?". Ai tha: "Po të tregoj! Bindja ishte nga Zoti, dhe Atë e falënderoj me madhërim ashtu siç e meriton dhe siç Ai e ka hak! Kur i hyra rrugës së diturisë, unë i mendova mirë të gjitha shkencat, lexova për secilën prej tyre një e nga një, dhe mendova për fundin ku më nxirrte secila, si edhe përfitimin që do të kisha prej secilës. Thashë t'i hyja shkencës së Fjalës, e atëherë shikova me kujdes, dhe pashë se përfundimi i saj ishte i keq dhe dobia prej saj ishte e vogël; kur njeriu përfundon së studjuari këtë shkencë, ai nuk mund të flasë hapur, njerëzit mund të flasin çdo të keqe për të, dhe mund të thonë se ai është një person që flet sipas tekave... Pastaj ndoqa çështjen e Gjuhës dhe të Letërsisë, dhe pashë se përfundimi i saj do të ishte të ulesha me fëmijët, t'u mësoja atyre Gjuhën dhe Letërsinë... Pastaj ndoqa çështjen e Poezisë, dhe

6. Muhamed Ebu Zahra, "Ebu Hanife".

pashë se përfundimi i saj ishte thurja lavde ose sharja, thënia e gënjeshtreve dhe përçarja e fesë... Pastaj mendova për çështjen e Kira'eteve (mënyrat e leximit të Kur'anit), dhe thashë: Pasi t'i shkoj deri në fund kësaj shkence, përfundimi do të jetë që rreth meje të mblidhen moshat e reja, e t'u mësoj atyre të lexojnë. Mendova se të folurit rreth Kur'anit dhe kuptimit që përmbajnë fjalët e tij është një gjë e vështirë...

Pastaj, thashë të hulumtoja shkencën e Hadithit, dhe mendova: Pasi të kem mbledhur shumë prej haditheve, do të më duhet një jetë e gjatë, derisa unë të bëhem i dobishëm për njerëzit në këtë fushë, e kur ta arrij atë pikë, rreth meje do të mblidhen vetëm moshat e reja, e ndoshta ata do të më akuzojnë për gënjeshtar apo për kujtesë të dobët, akuzë e cila do të më ndiqte deri në Ditën e Gjykimit... Pastaj iu ktheva Fikhut, dhe sa herë i kthehesha atij dhe e kërkoja, vlerësimi për të vetëm se më shtohet, dhe nuk gjeta mangësi në atë shkencë. Vëreja se ajo shkencë do të më krijonte mundësinë të qëndroja me dijetarë, juristë islamë, njerëz të ditur e me vizion, dhe do të përfitoja nga virtutet e tyre. Dhe pashë gjithashtu se kryerja e detyrave fetare, vetë feja dhe adhurimet e saj, nuk mund të zbatoheshin as të qëndronin pa e njohur këtë shkencë. Dynjaja dhe ahireti fitoheshin nëpërmjet kësaj diturie, dhe kush kërkonte të fitonte dynjanë nëpërmjet saj, kërkonte diçka shumë të madhe, dhe do të zinte një vend të lartë në të, dhe kush tentonte adhurimin dhe veçimin për adhurim, askush nuk do të mund t'i thoshte se adhuronte pa dituri, por do të thuhej se e mësoi diturinë dhe punoi sipas saj."⁷

Në fakt, Ebu Hanifja mori nga të gjitha shkencat e kohës. Ai e mësoi të gjithë Kur'anin e Bekuar përmendësh; edhe nga hadithet, ai arriti të merrte një masë të madhe njohurie në to... ai mësoi gjuhë, letërsi dhe poezi, gjithashtu polemizoi me grupacionet e ndryshme rreth çështjeve të besimit.

Më pas, ai studioi fetvanë, pranë mësuesve të njohur të kohës së tij, dhe njërin prej tyre e ndoqi në mënyrë të vazhdueshme. Në kohën e Ebu Hanifes, Kufja ishte vendi i juristëve të Irakut, ndërsa Basra njihej si vendi i grupacioneve të ndryshme, të cilët futeshin në polemika rreth çështjeve të besimit. Ky ambient intelektualësh, la gjurmë në shpirtin e Ebu Hanifes, gjë për të cilën ai kishte thënë: "Unë kam qenë në vendin e diturisë dhe të Fikhut,

7. Muhamed Ebu Zahra, "Ebu Hanife".

kam qëndruar mes dijetarëve, dhe i jam përmbajtur ndjekjes së njërës prej juristëve të atij vendi.”

Dijetari i Fikhut, të cilin e ndoqi Ebu Hanife ishte Hamad ibn Ebi Sulejman, një dijetar i shquar i kohës. Ebu Hanifja e shoqëroi këtë dijetar për tetëmbëdhjetë vite rresht, siç e ka thënë ai vetë, dhe pasi mësuesi i tij vdiq (në vitin 120 të hixhretit), Ebu Hanifja tashmë i kishte mbërritur të dyzetat e moshës së tij.

Në moshën dyzet vjeçare, Ebu Hanifja u bë zëvendësi i Shejhut të tij, Hamadit, dhe filloi të jepte mësim në Xhaminë e Kufes, gjithashtu jepte edhe fetva dhe gjykimet e veta për çështjet që i paraqiteshin.

Ai bënte krahasimin e çështjeve me të ngjashmet e tyre, derisa vuri atë metodë të Fikhut nga e cila doli Shkolla Hanefite, ose Medhhebi Hanefi⁸.

SHKOLLA HANEFITE

Shkolla Hanefite quhet ndryshe edhe Shkolla apo Medhhebi i njerëzve të mendimit, dhe është shkolla islame më e vjetër nga të katër shkollat e tjera të njohura të Islamit Sunit. Themeluesi i kësaj shkolle është Imam Ebu Hanife En-Nu'man. Fillimisht kjo shkollë u themelua në Kufe, në qytetin ku jetonte Imam Ebu Hanife, pastaj, pas vdekjes së tij, dijetarët e vazhduan aktivitetin e saj në Bagdad, e më pas këto mësimet u përhapën në pjesën më të madhe të territoreve Islame, si në Egjipt, Levant-Sham, në vendet që më parë kishin qenë nën pushtimin bizantin, në Irak e përtej lumit... pastaj i kaluan kufijtë për të mbërritur në Indi dhe në Kinë⁹.

Dijetarët më të mëdhenj që e përfaqësonin shkollën Hanefite, quheshin si “Njerëzit e mendimit”, sepse në Irak prezenca e Hadithit Profetik nuk ishte edhe aq e madhe. Për këtë arsye, ata e praktikuan shumë analogjinë, dhe u bënë mjeshtrë në të. Transmetohet se ndjekësit e Imam Ebu Hanifes, të cilët i shkruan mësimet e Shkollës së tij, ishin dyzet persona, prej të cilëve më të njohurit janë Ebu Jusuf dhe Zufer. Ndërsa, i pari që filloi t'i shkruante këto mësimet ka qenë Esed ibn Amru¹⁰.

Në epokën Abaside, në kohën e kalifit musliman Harun Er-Reshid, në vitin 170 të hixhretit, si gjykatësi më i lartë i shtetit u caktua Ebu Jusuf, njëri nga ndjekësit më të shquar të Imam Ebu Hanifes. Atij iu la në dorë caktimi i gjykatësve

të lartë në të gjitha provincat islame. Ebu Jusufi zgjodhi ata që ishin ndjekës të shkollës Hanfite, duke ua imponuar kështu publikut të gjerë gjykimet dhe fetvatë e tyre, dhe si rezultat Medhhebi Hanefi u përhap gjerësisht në ato vende. Në lidhje me këtë, dijetari i shquar Ibn Hazm, kishte thënë: “Dy janë medhhebet që në fillimet e tyre u përhapën nga sunduesit dhe udhëheqësit muslimanë: Medhhebi Hanefi në lindje dhe Medhhebi Maliki në Andaluzi.”¹¹

Bazat e shkollës Hanefite u ngritën mbi gjashtë burime: Kurani i Shenjtë, Suneti Profetik, Konsensusi mes muslimanëve për një çështje, Analogjia, Istihsan-i -Ajo çfarë është më e mira, dhe burimi i gjashtë dhe i fundit ishte Tradita dhe Zakonet e një populli¹².

Medhhebi Hanefi është medhhebi që dominon në vendet e Ballkanit, gjithashtu dhe këtu në Shqipëri.

SHKRIMET E IMAM EBU HANIFES

Epoka e Imam Ebu Hanifes nuk ishte një epokë shkrimi në kuptimin që dijetari të ulet i vetëm dhe të shkruajë, ose t'u diktojë nxënësve të tij të shkruajnë, gjë e cila u bë e njohur më vonë.

Ebu Hanifja nuk ishte shumë i angazhuar me shkrime dhe diktimit. Ai e kishte zakon që gjatë natës të falte namaz nafle deri në agim. Pastaj, kur agonte, pasi e falte namazin e mëngjesit në xhami, ai qëndronte atje për disa orë, duke u dhënë mësim njerëzve. Më pas shkonte në shtëpinë e tij për t'u marrë me nevojat e veta dhe të familjes, e më pas shkonte në treg për të shikuar punët e tregtisë dhe të çështjeve të jetesës... ose vizitonte ndonjë të sëmurë, përcillte ndonjë xhenaze, vizitonte ndonjë shok të tij... Pas namazit të drekës, ai pushonte derisa vinte koha e namazit të pasdites, pastaj, pas namazit të pasdites ulej dhe jepte mësim, ose u jepte përgjigje pyetjeve të njerëzve, deri në mbrëmje.

Kështu pra, mësimdhënia ia mori Imam Ebu Hanifes pjesën më të madhe të kohës, duke mos i lënë shumë hapësirë për shkrim. Në mexhliset e tij vinin nxënës nga Kufja e Basra, nga vende të afërta dhe të largëta, prandaj ai nuk la shumë punime të shkruara, pavarësisht pozitës së tij të lartë në dituri.

Por, gjithashtu, është vërtetuar se Imam Ebu Hanifja ka shkruar dy libra në shkencën e Fjalës: “El-Fikhul-Ekber

11. Ahmed Tejmur, "Nedhre Tarihiye fi Huduth El-medhahib El-fikhije El-er'ba".

12. Marrë nga libri: "Ebu Hanife En-Nu'man", i Imamit të shquar shqiptar Vehbi Sulejman Gaxho, Allahu e mëshiroftë!

- Fikhu i Madh” dhe “El-Fikhul-Evsat - Fikhu i Mesëm”.

Gjithashtu ka shkruar edhe librat “El-Alim vel-muteal'lim - Dijetari dhe nxënësi”, “Er-Risale - Mesazhi” drejtuar Mukatil ibn Sulejman (një autor shkrimesh në interpretimin e Kur'anit të Shenjtë), “Er-Risale - Mesazhi” (drejtuar Juristit të Basrës, Othman El-Bette), “El-Vesije-Porosia” (libër që përmban një numër porosish drejtuar shokëve të tij).

Imam Ebu Hanife shkroi dhe diktoi hadithe të ndritura të Profetit, alejhi selam. Në fakt, ai mblodhi shumë hadithe nga transmetuesit e shquar të hadithit të asaj kohe, derisa mbushi sëndukë me shkrime rreth tyre. Hadithet të cilat ai i tregonte dhe për të cilat fliste, i kishte zgjedhur mes dyzet mijë haditheve. Ai mblodhi hadithet që gjendeshin në Kufe, në gjithë Irakun, edhe jashtë tij, por në vend që të merrej me transmetimin, ai u mor me studimin e tyre nga ana juridike dhe kuptimore, dhe me mbledhjen e teksteve të tyre.

Jahja ibn Nasr ibn Haxhib tregon: E kam dëgjuar Ebu Hanifen, Allahu e mëshiroftë, të thotë: “Unë kam sëndukë të mbushur me hadithe të shkruar, por kam nxjerrë vetëm pak prej tyre, vetëm ato nga të cilat merret përfitim.”¹³

Hadithet që zotëronte Imam Ebu Hanifja janë mbledhur në shtatëmbëdhjetë Musnede. Ky dijetar i shquar i Islamit ishte i pari që i shkroi hadithet duke i renditur ato sipas temave të Fikhut - Jurisprudencës Islame¹⁴.

* * *

Ebu Hanifja vdiq në vitin 150 hixhri, në Bagdad, dhe u varros në varrezat e njohura Adhamija, emër që vendi e mori nga vetë ky imam i shquar, Allahu e mëshiroftë. Tregojnë se kur Ebu Hanifja e ndjeu se i ishte afruar vdekja, ai ra në sexhde, dhe në atë gjendje ndërroi jetë. Qysh më parë ai kishte porositur të varrosej në një tokë të mirë. Në varrimin e Imamit të madh prezantuan i gjithë Bagdadi, dhe thonë që në namazin e xhenazes së tij morën pjesë rreth pesëdhjetë mijë persona¹⁵.

Allahu e mëshiroftë Ebu Hanifen, dhe e shpërbleftë me shpërblimin më të mirë për shërbimin që ai i bëri fesë së Allahut!

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

13. Marrë nga libri: "Ebu Hanife En-Nu'man", i Imamit të shquar shqiptar Vehbi Sulejman Gaxho, Allahu e mëshiroftë!

14. Po aty.

15. Muhamed Ebu Zahra, "Ebu Hanife".

MYFTIU MORI PJESË NË MEVLUDIN E XHAMISË “BUHARA” NË SULGEN TË ZVICRËS



Mbrëmjen e së shtunës, më 30 nëntor 2019, në një atmosferë të mrekullueshme besimi dhe vëllazërie islame, Xhamia “Buhara” në Sulgen të Zvicrës organizoi një program fetar me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s.).

Programi, që zgjati mbi tre orë, ishte i mbushur me mesazhe të forta besimi, harmonie, solidariteti e dashurie për të dërguarin e All-llahut (xh.sh.).

Një mesazh i ngrohtë e plot emocion ishte edhe ai i Hoxhës Amet Memeti, imam i xhamisë “Buhara”, i cili vuri theksin tek rëndësia që ka nxitja dhe përhapja e dashnisë për Resulull-llahun (a.s.) në jetën e muslimanit.

Ai lexoi edhe disa nga vargjet e bukura të Burdes së Imam Busirit, vargje që lexohen përherë me shumë emocion e nderim për më të mirin e krijesave të Zotit.

Hoxha i nderuar u lut edhe për viktimat e tërmeteve të Shqipërisë dhe theksoi se dhimbja e shkaktuar nga tërmetet e ditëve të fundit na ka prekur të gjithëve dhe krejt jemi të ftuar të solidarizohemi e të ndihmojmë me sa të kemi mundësi.

I ftuar special i këtij Mevludi ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili mbajti një ligjëratë mbi rëndësinë e tubimeve të Mevludit Sherifë, vlerën e madhe që kanë këto tubime të Thirrjes Islame dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së këtyre traditave të dobishme islame, që mbajnë të gjallë përkujtimin e Hz. Muhammedit (a.s.).

Myftiu tha se: “Sfida e jonë është angazhimi për të dëshmuar botërisht se jemi ymeti i tij (a.s.), me mëshirën tonë për krijesat e Zotit, me humanizmin

tonë duke dashur për tjetrin atë që duam për veten tonë, me modestinë tonë, me vullnetin për të bërë mirë e për të mbjellur mirësi e paqe kudo e me këdo!

Sfida e jonë është leximi i drejtë dhe me urtësi i teksteve të urta të Resulull-llahut (a.s.), duke i kuptuar si duhet, duke u përpjekur për t'i kthyer në natyrë të qëndrueshme e shembull, që lexohet në sjelljen tonë edhe nga të tjerët, duke mos paragjykuar e mos përbuzur njeri, kushdo qoftë ai.


Pyete veten: A e njoh unë Resulull-llahun (a.s.), shembullin e tij, moralin dhe mëshirën e tij? A jam unë pasues i sinqertë i traditave të tij, apo tekanjoh në përzgjedhjen e asaj që vjen nga i Dërguari (a.s.), për të cilën, Zoti i gjithësisë ka urdhëruar: “Çka t’ju japë Pejgamberi, atë merreni, e çka t’ju ndalojë, përmbajuni dhe kini frikë All-llahun”.

Sot, secili prej nesh është i ftuar të bëhet pjesë e kësaj thirrjeje të begatë islame; të shkojë pas të Dërguarit të All-llahut, thirrja e të cilit ishte e mbushur plot mëshirë e humanizëm, plot drejtësi e tolerancë, plot dritë e dije, plot nxitje për përparim dhe lutje për ata që sjellin risi të dobishme për shoqërinë!

Sot, nëpërmjet tubimeve të paqta të përkujtimit të Resulull-llahut (a.s.), na jepet mundësia për të thirrur me zemër: UDHËZIMI YT, RRUGA IME..!.”

Aktivitetin e përshëndeti edhe imami i xhamisë së qytetit Wil, H. Bekim Alimi, njëkohësisht kryetar i DIGO (Federata e Muslimanëve në Zvicrën Lindore).

Kjo mbrëmje e begatë u pasurua edhe nga ilahitë dhe leximet e ajeteve të ndryshme kur'anore nga H. Daut Lezi dhe H. Muhsin Sulejman, paraqitja e të cilëve dhuroi emocione të paharrueshme.



"Muhammedi

është njeriu

më i fortë që

ka ngritur një

shtet mbi baza

drejtësie dhe

tolerance!"

George Wells

AKTIVITETI “MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI” MES NXËNËSVE TË XHAMIVE OBLIKË DHE VELINAJ

Ditën e shtunë, më 30 nëntor 2019, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit organizoi në Oblikë aktivitetin e radhës me temë: “Mësojmë dhe argëtohem” me nxënësit e kësaj xhamie dhe nxënësit e kurseve fetare të xhamisë Velinaj.

Në këtë aktivitet drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, gjatë takimit me nxënësit u mbajti një bisedë fetare, ku u foli për rëndësinë që ka zhvillimi i mësim-besimit, për njohuritë kryesore të Islamit dhe për edukimin e brezave sipas frymës tradicionale islame, besimit dhe moralit që duhen të karakterizohen me përkushtimin ndaj Zotit (xh.sh), dashurinë dhe paqen më të gjithë njerëzit.

Përgjegjës i arsimit falënderoi mësuesit e dy xhamive Oblikë dhe Velinaj, respektivisht Nadi Braçi dhe Nebi Alia për angazhimin e tyre në edukimin e brezave



të ri, si dhe për gjallërimin e xhamive me veprimtari të ndryshme islame.

Sipas programit, u zhvillua një konkurs fetar në lëndët që mësohen në

kurset fetare gjatë procesit mësimor: Kur'an, Ilmihal dhe Edukatë Islame, biseda në mes nxënësve, shëtitje si dhe lojëra të larmishme sportive.

Në një atmosferë të begatë besimi dhe vëllazërie, Myftinia Shkodër dhe Fondacioni “Mirësia”, organizuan të xhumanë, më 6 dhjetor 2019, ceremoninë e përvitmit të xhamisë së re të fshatit Shirq, Njësia Administrative Dajç.

Xhamia e re e Shirqit është ndërtuar falë kontributit të familjes së nderuar, Dr. Nebil Abdurrahim nga Kuvajti.

I pranishëm, bashkë me familjen e tij, donatori kuvajtian shprehu kënaqësinë e realizimit të kësaj xhamie të re, ku tha se vendet e adhurimit na ftojnë përherë drejt Zotit dhe nxisin edukimin e brezave, përhapjen e paqes dhe harmonisë në mesin e njerëzve.

Ai falënderoi zonjën e tij dhe fëmijët, që ia bënë këtë dhuratë të bukur, si një surprizë të pamenduar, të cilës i vendosën emrin e tij!



U PËRURUA XHAMIA E RE E FSHATIT SHIRQ



Të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe Ambasadori i Kuvajtit, Sh.T.Z. Fayed Mishari Al-Jasim, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Hilmi Lakti, nën/Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, Famullitari i Kishës së Shirqit, dom Marjan Gega, Famullitari i Kishës së Velipojës, dom Gjovalin Simoni, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, Drejtori i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, z. Kujtim Dervishi, etj.

Mesazhe të shumta të paqes, harmonisë dhe bashkëpunimit për të mirë, dhanë të ftuarit e nderit në këtë ceremoni të gëzueshme.

Ceremoninë e përshëndetën edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari dhe Drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, të cilët ndanë gëzimin e madh të përfundimit të këtij projekti, si një domosdoshmëri për muslimanët e zonës Shirq-Mushan.

Më herët, Ambasadori i Kuvajtit falënderoi familjen Abdurrahim nga Kuvajti dhe vlerësoi bashkëpunimin për realizimin e projekteve që sjellin dobi për komunitetin.

Pas prerjes së shiritit të përvitmit, të pranishmit e shumë falën baahkarisht edhe namazin e xhumasë së parë në xhaminë e re të Shirqit!

MEVLUDI SHERIFË, TUBIMI TRADICIONAL NË XHAMINË E TRUSHIT

Paraditën e së hënës, më 9 dhjetor 2019, në xhaminë e fshatit Trush u zhvillua një aktivitet i bukur fetar, në përkujtim të Lindjes së Begatë të Hz. Muhamedit (a.s.).

Aktiviteti nisi me leximin e një pjese kur'anore nga imami i xhamisë së Barbullushit, z. Ervis Molla.

Më pas, imami i xhamisë së Trushit, H. Jetmir Braçi, uroi të pranishmit e shumë për mirësinë e pjesëmarrjes në këtë tubim me vlera besimi dhe, që mbi të gjitha ka për qëllim nxitjen e dashurisë dhe lidhjes me të Dërguarin e All-llahut dhe mesazhin, me të cilin u dërgua.

Ligjëratat e këtij tubimi u mbajt nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili shprehu kënaqësinë e tij për këtë organizim, që reflekton më së miri ruajtjen e traditave të bukura islame, që lidhen me përkujtimin e Resulull-llahut



(a.s.) dhe përhapjen e madhështisë së traditave të tij në mesin e njerëzve.

Myftiu solli në vëmendje të besimtarëve argumente të ndryshme, që bëjnë fjalë për pozitën e lartë të Hz. Muhamedit (a.s.) ndër të dërguarit e All-llahut, si dhe pozitën e ymetit të tij ndër krejt shoqëritë e mëparshme

njerëzore.

Aktiviteti vijoi me këndimin e disa pjesëve të përzgjedhura nga “Mevludi” i H. Ali Ulqinakut, salavateve dhe ilahive të ndryshme.

Nën drejtimin e Myftiut, të pranishmit falën edhe namazin e mesditës me xhematë.

U PËRKUJTUA 5 VJETORI I HAPJES SË XHAMISË SË “DY VAJZAVE”

Mbrëmjen e së enjtes, më 12 dhjetor 2019, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet përkujtimor, me rastin e hapjes së xhamisë së “Dy Vajzave”, në vakëfin e Shaban efendisë.

Aktiviteti nisi me shfaqjen e një materiali të përgatitur me momentet më të spikatura të veprimtarisë së kësaj xhamie, në 5 vitet e para të aktivitetit të saj.

Më pas, imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja, mbajti një fjalë, ku vlerësoi aktivitetin e këtyre pesë viteve, sikurse falënderoi donatorin dhe krejt kontribuuesit për plotësimin e kësaj xhamie deri në këtë pamje që ka sot.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili falënderoi kontributin e ing. Ahmed Esh-Shaia nga Kuvajti, sikurse vlerësoi kontributet e mëdha të Shtetit të Kuvajtit, si një shembull për t'u ndjekur në bamirësi e solidaritet me mbarë njerëzimin.

Myftiu shprehu mirënjohjen e tij për kontributin e madh të ish-drejtorit të Institutit Shqiptar të Mendimit dhe



Qytetërimin Islam, Dr. Ramiz Zekaj, për realizimin e këtij projekti me vlerë për Shkodrën.

Njëkohësisht falënderoi imamin e xhamisë, muezinin, këshillin e kësaj xhamie dhe xhematin e saj për angazhimin e vazhdueshëm për ta bërë këtë xhami sa më të dashur e funksionale për shtresat e ndryshme të shoqërisë.

Një ligjëratë me vlerë, titulluar: “Xhamia dhe sfiat e kohës”, mbajti imami i xhamisë “Ebu Bekër”, në Fushë

Çelë, teologu Idmir Plaku.

Imami i nderuar vlerësoi rëndësinë që ka xhamia në jetën e muslimanëve, rolin e imamit si prijës elitare dhe domosdoshmërinë e xhematit cilësor, që di të respektojë traditat dhe që distancohet nga rrymat e dëmshme, trendet joetike dhe që punon pa ndërprerje për të mirën në komunitet.

Për të pranishmit u shpërnda literaturë islame, sikurse u fal edhe namazi i jacisë me xhematë.

PËRKUJTOHET MEVLUDI SHERIFË NË XHAMINË E BARBULLUSHIT



Paraditën e së hënës, më 16 dhjetor 2019, në xhaminë e fshatit Barbullush u zhvillua aktiviteti fetar, në përkujtim të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s.).

Aktiviteti u hap me leximin e një pjese kur'anore nga H. Ramazan Avxhi.

Më pas, e mori fjalën imami i xhamisë së Barbullushit, H. Ervis Molla, i cili pasi uroi të pranishmit e shumtë për pjesëmarrjen e tyre në këtë aktivitet me vlera fetare, foli mbi rëndësinë e Mevludit Sherifë dhe përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Pejgamberit (a.s.).

Ndërsa, teologu Idmir Plaku, imam i xhamisë "Ebu Bekër" foli mbi kuptimin e ajetit "Për besimtarët, ai (Pejgamberi) është i mëshirshëm dhe i dhembshur",

duke sjellë shembuj të ndryshëm nga jeta e Pejgamberit (a.s.) dhe përkujdesjen që i Dërguari i All-llahut ka treguar për sahabët e tij të nderuar dhe mbarë ymetit islam.

Aktiviteti vijoi më pas me këndimin e disa pjesëve të përzgjedhura nga "Mevludi" i H. Ali Ulqinakut, ilahive të ndryshme, salavateve të herë pas hershme, të kënduara me xhemat, dhe recitime të Esmaul-Husna nga nxënësit e kursit fetar të kësaj xhamie.

Në aktivitet ishin të pranishëm gjithashtu, Hfz. Shukri Kapllan, imam i xhamisë Krye-Bushat, H. Bujar Haxhani, imam i xhamisë Kosmaç, H. Vullnet Pishtari dhe këndues të Mevludit z. Qamil Ujka dhe Samet Tula.



"MARRËVESHJA OMERITE"

Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim

Të drejtat që rob i All-llahut, Omeri, prijësi i besimtarëve u jep banorëve të Iljas:

"U jep atyre siguri për veten, pasurinë, kishat dhe kryqet e tyre. Për njerëzit e sëmurë, të shëndoshë dhe kushdo qofshin ata. Kishat do të qëndrojnë ashtu siç janë, nuk do të shkatërrohen dhe as nuk do të ndryshohen. Nuk do të konfiskohej asgjë prej pasurisë së kishave dhe as prej pasurisë së tyre. Njerëzit do të jenë të lirë dhe nuk do të detyrohen dhe as nuk do të ushtrohet presion mbi ta për të ndryshuar fenë."

Për çdo gjë që është shkruar në këtë marrëveshje, ka besën e Allahut, garancinë e të Dërguarit të tij, të kalifëve dhe të gjithë myslimanëve.

Dëshmitarë për këtë marrëveshje janë: Halid ibn Velid, Amër ibn As, Abdurrahman ibn Auf dhe Muavije ibn Ebi Sufjan.

Marrëveshja u nënshkrua në vitin 15 h-637.

MYFTIU: "MOSBESIMI, SHKATËRRIM PËR JETËN E NJERIUT NË TOKË!"

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga sekretari i Këshillit të Myftinisë, H. Fejzi Zaganjori dhe teologu Lavdrim Hamja, zhvilloi ditën e mërkurë, më 25 dhjetor 2019, vizitat tradicionale në dy kishat e Shkodrës, prej ku përcollti edhe mesazhin e tij të kësaj dite.

Myftiu uroi fillimisht në kishën ortodokse, pastaj në kishën katolike, ku ndau mesazhet e tij me Atë Aleksandër Petanin dhe Mons. Angelo Massafra.

Në një mesazh mediatik, Myftiu theksoi se: "Përtej datave, është e rëndësishme të përqendrohemi tek mesazhet e momenteve të shënuara, që njeriu të kthehet nga Zoti e të paqtohet me Të!"

Jemi dëshmitarë se, gjithandej nëpër botë ka kriza e luftëra, gjakderdhje, shtypje e shkelje të drejtave të njeriut. E, kjo, nëse buron nga diçka, buron nga mosbesimi dhe largimi i njeriut nga dera e Zotit.

Prandaj, mesazhi më i mirë i komuniteteve fetare është lidhja dhe afrimi i njeriut me Zotin e gjithësisë dhe me njëri-tjetrin, për të jetuar në paqe e larg padrejtësive!"

Kalova nga urrejtja ndaj Islamit, duke u bërë një mysliman. Liverpooli është arsyeja kryesore për këtë.

Mohamad Salah me të vërtetë dhe ndershmërisht më inspiroi.

Unë jam një mbajtës biletash sezonale i Nottingham Forestit.

Unë mund të jem vetvetja, por kam deklaruar dëshminë e besimit dhe tani jam një mysliman.

Unë, vazhdoj të jem unë, e kjo është ajo e cila kam marrë nga Muhamed Salah.

Do të kisha dëshirë ta takoja dhe ta përshëndes duke i shtrënguar dorën dhe t'i them: Gëzuar! ose Shukran! (Faleminderit).

Nuk mendoj që shokët e mi do ta besojnë që unë jam një mysliman, sepse unë në të vërtetë s'kam ndryshuar. Unë thjesht mendoj që zemra ime është më e mirë. Por, me të vërtetë po mendohem të ndryshoj me kalimin e ditëve.

Aty afër kam një klub, vendosja një bast dhe pasta, pas lojës, kthehesha në pub, dhe pas kësaj vija re që kisha humbur shumë para.

Është e vështirë kur je mësuar në njëfarë kulture të tillë dhe është pjesë e futbollit për shumë njerëz.

Më vjen të turpërohem ta them këtë, por opinionet e mia rreth Islamit ishin që feja, kultura dhe njerëzit ishin të prapambetur; që ata nuk ishin të integruar dhe donin të pushtonin çdo gjë. Gjithmonë i shikoja myslimanët si elefant në dhomë dhe kisha urrejtje të madhe ndaj tyre.

Kur isha në klasën e gjashtë në kolegji, atëherë ishte një periudhë kohe kur unë mendoja që më duhej t'i vija fajin dikujt për fatkeqësitë e mia. Fatkeqësisht myslimanët e morën fajin të gjithin, dhe unë shpejt zbulova fytyrën e krahut të djathtë.

Ata më bënë një lloj ujdje duke më nisur tekste të gjata propagande dhe të tjera të ngjashme. Edhe pse kisha këto ide të tmerrshme rreth Islamit, kurrë nuk do t'ia thoja ato një myslimani. Atëkohë, nuk njihja asnjë mysliman, por niveli i studimeve të mia mbi Lindjen e Mesme në universitetin e Leedsit ndryshoi gjithçka.

Kishim për të bërë një tezë universitare dhe dëshiroja të bëja diçka ndryshe. Mbaj mend mentorin tim, që më thoshte: Çfarë mendimi ke për këngën e Muhamed Salahit? Isha në dijeni të plote të asaj kënge dhe mendoja se ishte fantastike, por kurrë nuk e kisha

SI MË FRYMËZOI MUHAMED SALAH, QË TË BËHEM MYSLIMAN?

konsideruar në atë kuptim.

Më së fundmi, e mora përgjigjen: Muhamed Salah, është një dhuratë nga Allahu.

Është performanca e Muhamed Salahit, ajo e cila ndez çdo dialog, që lufton islamofobinë, bashkë me të median dhe fushën politike.

Kënga e fansave të skuadrës së Liverpoolit – Në melodinë e hitit të Dodgysa-ve mjaft mirë – përfshin rreshtin: Nëse ai shënon edhe disa të tjerë, atëherë unë do të jem një mysliman. Në mënyrë direkte unë e mora atë për zemër.

Isha një djalosh tipik i bardhë, i cili shkon në një qytet tjetër, që dëshiron absolutisht të jetë i pavarur dhe të jetojë jetën studentore. Në klasën time, ishte hera e parë ku unë mësova për Islamin në mënyrë akademike.

Universiteti më dha mundësinë që të njihja shumë studentë nga Arabia Saudite. Mendoja, se ata ishin njerëz të këqij që mbanin shpata, por në të vërtetë ata ishin njerëzit më të mirë që unë kisha njohur. Konceptet që kisha ndaj vendeve arabe u shpërbënë plotësisht.

Muhamed Salah ishte myslimani i parë që unë mund të lidhesha me të, ishte mënyra sesi ai jetonte jetën, mënyra sesi u fliste njerëzve. Javën tjetër ai pozoi një foto me një fans të Liverpoolit, i cili u lëndua me thyerjen e hundës duke e ndjekur atë nga pas. E di, që edhe futbollistët të tjerë do ta bënin këtë, por ti e pret këtë gjë tani nga Muhamed Salah.

Në universitet, intervistova disa studentë egjiptianë dhe kur ata panë, se kërkimi im ishte: "Muhamed Salah një dhuratë nga Allahu", e cila është gjithashtu një këngë tjetër e skuadrës së Liverpoolit, ata mund të flisnin me mua për orë të tëra, sesa gjigant është ai, dhe se çfarë ka bërë ai për vendin e tyre.

Vitin që kaloi, një milion egjiptianë prishën fletët e votimit, duke e votuar atë për president. Njëri nga egjiptianët, me të cilin folja, me tha se Salah përfaqëson atë çfarë është të jesh një mysliman, duke ndjekur Islamin në mënyrë të rregullt.

Ai besonte, se Salah po bën të mundur që njerëzit t'i duan myslimanët përsëri.

Kjo me të vërtetë ndodhi me mua, kur Salah shënon, unë mendoj se ai po shënon për besimin, ndërsa kur ai fitoi Champions Ligën, unë i thashë një shokut

tim, kjo është një fitore për Islamin.

Pas çdo goli të tij, Salah bën sexhde, dhe kështu i ekspozon botës një simbol tepër islam. Sa milionë njerëz shohin Champions Ligën çdo javë? Miliona nëpër botë.

Salah më tregoi mua që mund të jesh një njeri normal dhe një mysliman në të njëjtën kohë, nëse kjo është shprehja e duhur. Mund të jesh vetvetja... Ai është një lojtar futbollit dhe ai është i respektuar nga i gjithë komuniteti i futbollit dhe nga politikanët e tij.

Feja e tij nuk ka rëndësi, dhe për mua kjo është ajo që futbollit mund të bëjë.

Kur njerëzit lexojnë Kur'anin ose lexojnë rreth Islamit ata shohin diçka ndryshe që jo gjithmonë paraqitet nëpër media.

Unë jam i ri në komunitetin islam dhe vazhdoj të mësoj, është e vështirë, dhe është një stil jetese ndryshe.

Çfarë mund t'i them Benit të vjetër? Do t'i jepja një grusht, që të jem i sinqertë, dhe do t'i thoja: Si guxon të mendosh ashtu për njerëz, të cilët janë kaq ndryshe? Ti ke nevojë të fillosh të flasësh me njerëzit. Ti ke nevojë të fillosh të pohosh: Ne jetojmë në një komunitet multikulturor, multireligjioz, multi-etnik.

Sezonin e fundit, fansat e skuadrës së Chelsit po këndonin: "Salah është një bombardues". Kjo ishte hera e parë që në rrjetin tim social kisha lëvizjen e duhur.

Isha jo mirë, sepse isha për një barcaletë futbollit, por ti e merr vesh kur gjërat thjesht nuk janë të vërteta.

Tani, mund t'i them fëmijëve myslimanë: Mos kini frikë të shkoni në një ndeshje futbollit, unë mendoj se është një problem që duhet të shikohet nga të dyja palët.

Kisha frikë nga të qenurit i ndarë në një anë, dhe nuk dua që të humbas shokët e mi, sepse i shikoj ata si vëllezërit e mi, ndërsa tani unë kam 1/5 e botës si vëllezër dhe motra të mia.

Komuniteti duhet të ndahet, të luajë futboll, ose të shkojë të shikojë futboll. Është në dorën tonë që ta kuptojmë, se në këtë gjë jemi të gjithë së bashku, dhe folësi më i mirë për këtë mund të jetë Muhamed Salah!

Ben Bird për "Tusdiq Din"
(www.theguardian.com)

Përktheu nga anglishtja:
Ervil Kuçi

LIBRI “BISEDË ME TË RINJTË” I HOXHËS SË NDERUAR, OSMAN NURI TOPBASH

Libri me titull “Bisedë me të rinjtë” i Hoxhës së nderuar Osman Nuri Topbash i sjell në shqip nga teologia Elona Sytari, është një gurë qosheje në ngrehinën e vlerave dhe njohurive që duhet të stolisin të riun musliman bashkëkohorë, aq më tepër në kohën dhe vendin ku jetojmë. Libri synon pajisjen e rinisë muslimane me këndvështrime të sakta në lidhje me shumë çështje besimore, metodologjike dhe edukative.

Libri është i formuluar në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve, të cilat gjithsej janë dymbëdhjetë pyetje dhe përgjigje. Libri trajton tematika të ndryshme për nga përmbajtja.

Për hir të vërtetës, libri është i mbushur me mesazhe plot dritë, për një jetë më të mirë për veten, për tjetrin dhe vendin, e si rrjedhojë, nuk mund t'i jepet haku në një shkrim të shkurtër si ky por, po mundohemi të japim pakëz nga ajo çka ka, për të nxitur leximin e plotë të tij.

Hoxha e çelë librin e tij me një temë mjaft të goditur. Si ka arritur Pejgamberi (a.s.) të ndërtojë një shoqëri model, në atë kohë, vend dhe me ata njerëz, dhe si mund ta arrijmë ne, atë që ka arritur Pejgamberi (a.s.)? Në përgjigje të kësaj, Hoxha na jep një përmbledhje të metodave edukative, arsimore, udhëheqëse, drejtuese të Profetit (a.s.). Na jep një panoramë të edukimit shpirtëror që ai, i ka dhënë sahabëve, me të cilin ata arritën të jenë gjenerata më e bekuar. Kjo është pjesa më e gjatë në libër.


Tek trajtesa e dytë, Hoxha, në lidhje me rrugët që duhet të ndjekë i riu, që të arrijë qëndrueshmërinë në fe, Hoxha përmend si element të parë, shoqërimin me besimtarë të drejtë, dhe sjell një detaj mjaft interesant e shumë të gjetur kur citon e thotë: “Qeni i banorëve të shpellës (A’shabi Kehf) fitoi një nderim të madh duke u përmendur në Kur’an, ngaqë u shoqërua me njerëz të mirë.” - (f. 51-52).

Ky fragment përcjell një mesazh tejet të fortë e kuptimplotë se sa i rëndësishëm është shoku me të cilin shoqërohet i riu. Shoku është ai që në mënyrë indirekte formëson konturet e të ardhmes së të riut në një farë mënyre.

Në trajtesën e tretë, Hoxha trajton çështjen e ateizmit dhe dezimit, por këtij të fundit i jep më pak hapësirë. Fenomeni

i parë tek ne, është më tepër i përhapur për shkak edhe të kaluarës komuniste por, edhe si pasojë e “mahnitjes” nga zhvillimet dhe zbulimet shkencore të dekadave të fundit.

Hoxha sjell një mori argumentesh dhe faktesh shkencore që mbështesin besimin në një Zot të Vetëm e të



“Tesavufi është një disiplinë pastrimi, kullimi. Është rruga drejt devotshmërisë duke u shmangur nga çdo gjë që të largon nga Krijuesi i gjithësisë. Është një edukim shpirtëror që mban frerin e dëshirave egoiste duke kultivuar prirjet e larta shpirtërore”.

Gjithëdijshtëm por, që edhe përcjellin se nuk janë thjesht ligjet e natyrës ato që kanë sjell në jetë universin, sepse ligjet janë thjesht përshkrim i asaj çfarë ndodhë, dhe asgjë më tepër. Ato domosdoshmërisht kanë një krijues dhe rregullues.

Ndërsa për Deizmin ndër të tjera ai shprehet: “Si rezultat i trishtë i mungesës së një edukimi të duhur islam, sot përballemi edhe me problemin e deizmit”. Sipas kësaj teze, Zoti ekziston, sepse nuk ka sesi të mohohet, po ashtu

sikurse Ai krijoi bimët e bagëtisë dhe nuk i ngarkoi me detyrën e adhurimit, edhe njeriu është i tillë, pra pa përgjegjshmëri, pa ndonjë detyrim”. - (f. 79).

Në trajtesën e katërt, Hoxha flet rreth një fenomeni të vjetër por edhe të ri njëkohësisht, i cili është fenomeni i “kuranijunëve”, atyre që bëjnë thirrje për t’u bazuar vetëm tek Kur’ani, dhe për të hedhur tutje sunetin e Pejgamberit (a.s.). Ndoshta ky fenomen nuk është shumë i përhapur në vendin tonë, por në botën islame ka, dhe ka pasur lëvizje dhe individë të devijuar që kanë nxjerrë krye herë pas herë dhe kanë tentuar të helmojnë mendjen e rinisë me këtë thirrje. Hoxha e trajton më së miri këtë temë, me plot argumente bindëse dhe shteruese.

Në trajtesat, pesë, gjashtë dhe shtatë, Hoxha flet rreth tesavufit, si: Çfarë është dhe çfarë nuk është tesavufi? Flet rreth “Eulijave”, ose miqve të Allahut. Kush është dhe kush nuk është mik i Allahut. A kemi ne nevojë sot për tesavuf dhe a mund të rrugëtohet pa të?

Në trajtesën e pestë Hoxha flet rreth tesavufit dhe hakikatit të tij. Një temë që është keqkuptuar dhe keqinterpretuar shumë. Hoxha në përkufizimin që i bën Tesavufit ndër të tjera thotë: “Tesavufi është një disiplinë pastrimi, kullimi. Është rruga drejt devotshmërisë duke u shmangur nga çdo gjë që të largon nga Krijuesi i gjithësisë. Është një edukim shpirtëror që mban frerin e dëshirave egoiste duke kultivuar prirjet e larta shpirtërore”. (f. 98)

Në një vend tjetër ai thotë: “Mrekullia e vërtetë është istikameti”, (f. 105). Pra është qëndrueshmëria në fe dhe stabiliteti e jo ndonjë gjë tjetër, siç është përhapur tek shumë prej pretenduesve të tarikateve sufiste të devijuara.

Në trajtesën e tetë Hoxha hedh dritë mbi ndikimin negativ të teknologjisë në jetën njerëzore, ku ndër të tjera nge pyetjen dhe thotë: “Cili është rezultati i zhvillimit të teknologjisë? I orientoi njerëzit drejt harresës së ahiretit ...”. - (f. 135)

Hoxha shprehet se, si pasojë e përdorimit në masë të teknologjisë (rrjeteve sociale), po humbasin vlerat më të cilat brezat e parë kanë jetuar dhe janë lartësuar. Hoxha përmend një realitet që për shumë njerëz sot mund

Në kohën që jetojmë modelet që rinia merr dhe që i serviren nëpërmjet burimeve të ndryshme, janë ku s’ka më keq! Prandaj rinia muslimane duhet të kthehet tek modelet që përcjellin besim në rrallë të parë. Modelet në historinë tonë të ndritshme islame janë me bollëk e të larmishme, ku secili i ri mund të gjej veten e tij.

të duket si diçka utopike, por në të vërtetë ai përcjellë vlerat e fesë tonë dhe virtytet e saj. “Në atë kohë nuk kishe as qese plastike, por çanta që pengonin ekspozimin e gjërave që kishin brenda. Kur dilnim të blinin në pazar na thuhej: Kujdes mos na sillni fruta e perime që kanë ngelur në syrin e nevojtarëve”. - (f. 137)

Ah, sa larg këtij realiteti plot vlera besimore është realiteti i sotëm i rrjeteve sociale ku tipar dallues ka ekspozimin e momenteve dhe gjërave “më të zgjedhura të njeriut”, pa marrë në konsideratë ndjenjat e asujt!

Në trajtesën e nëntë, hoxha hedh dritë mbi alternativën që paraqet Islami si sistem jete përballë sistemeve që serviren sot, siç janë kapitalizmi, liberalizmi dhe komunizmi. Këtu, Hoxha shpalos atë se si e menaxhon Islami individin dhe shoqërinë me të gjithë kompleksitetin e tyre, duke hequr paralele me sistemet aktuale në shumë aspekte shoqërore dhe ekonomike.

Ndërsa në trajtesën e dhjetë, Hoxha diskuton rreth fenomenit të islamofobisë duke iu përgjigjur pyetjes: “Përse thuhet pikërisht Islamofobi, ndërkohë, që për fetë e tjera nuk përdoret termi fobi, frikë”? Me pak fjalë, Hoxha e përmbledh kështu përgjigjen: “Pema që ka fruta goditet”, “E kota shqetësohet nga e drejta”. - (f. 161)

Hoxha gjithashtu thekson se aktet e dhunës nuk kanë të bëjnë me Islamit dhe sjell shembuj nga jeta e Pejgamberit (a.s.), i cili ka qenë mëshirë për të gjithë njerëzit. Gjithashtu ai thekson se terroristët e vërtetë nuk janë muslimanët,

por ato që shkaktuan dy luftëra botërore, prej të cilave u vranë me dhjetëra miliona njerëz dhe nuk ishin muslimanët ata që e bënë këtë, dhe që vazhdojnë ta bëjnë këtë terror në Palestinë, Mijanmar etj.

Në trajtesën e njëmbëdhjetë, Hoxha flet rreth xhihadit. Rreth këtij termi të shumëpërdorur, por edhe të keqpërdorur. Ai e paraqet këtë pjesë të rëndësishme të fesë islame në formën e tij të pastër dhe më të qartë. Ai shprehet: “Qëllimi i xhihadit nuk është derdhja e gjakut... por është dëshira për të pushtuar zemrat... Domethënia e xhihadit nuk është vrasja e njeriut, por zhdukja e së keqes, është eliminimi i padrejtësisë, është udhëzimi i njerëzve, është ngjallja e zemrave, ky është thelbi i xhihadit”. - (f. 173)

Për ta kristalizuar më tepër këtë term, ai thotë: “... mbrotja e atdheut, e fesë, ruajtja e nderit, mbrotja e gjërave të shenjta ... është gjithashtu pjesë e xhihadit... ta shohësh xhihadin vetëm si “luftë të armatosur”, do të thotë ta kufizosh përmbajtjen e këtij koncepti”. - (f. 175)

Por, nuk duhet mohuar se shumë muslimanë e kanë keqpërdorur dhe keqinterpretuar këtë padrejtësisht, duke ia mveshur Islamit ato çka nuk i ka.

Libri mbyllet me një pyetje rreth lidhjes së Hoxhës me dijetarin e njohur Xhelaluddin Rumiun, si dhe ndikimin që ka pasur ai tek Hoxha.

Këtu, Hoxha na sjell copëza nga urtësitë e këtij mistiku të madh, të cilat janë plot dritë, të ardhura në formën e tregimeve dhe fabulave.

Mendoj, se Hoxha në këtë pikë ka dashur të përcjellë tek të rinjtë rëndësinë e të pasurit një model në jetën tonë, dhe nuk ka dashur të flasë vetëm për “Meulanen”.

Në kohën që jetojmë modelet që rinia merr dhe që i serviren nëpërmjet burimeve të ndryshme, janë ku s’ka më keq! Prandaj rinia muslimane duhet të kthehet tek modelet që përcjellin besim në rrallë të parë. Modelet në historinë tonë të ndritshme islame janë me bollëk e të larmishme, ku secili i ri mund të gjej veten e tij.

Përfundime

Libri është një sunduk plot margaritarë për rininë tonë, por jo vetëm. Është i lehtë për t’u lexuar, me gjuhë të bukur dhe larg rëndësës së termave të shumtë.

Durim Kasemi, teolog
Prof. dr. Njazi Kazazi



"NË PUNË SHKOJNË NË ORAR; NË AEROPORT SHKOJNË PËRPARA ORARIT TË FLUTURIMIT; NË SPITAL SHKOJNË PËRPARA TAKIMIT, GJITHASHTU! PASTAJ, FLENË PËR NAMAZ DHE THONË: PROBLEMI JONË ËSHTË GJUMI I RËNDË! "JO, POR I JEPNI PËRPARËSI JETËS SË DYNJASË".

(Kur'ani, El-E'ala: 16)

Dr. Ahmed Isa El-Ma'saravi



XHAMIA E RE NË FSHATIN SHIROQ 6 DHJETOR 2019



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org